

Asociacioni
i Komunave
Serbe: **Kuptimi**
i pikëpamjeve
kundërthënëse të
shqiptarëve dhe
serbëve

Ky raport është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) - i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e Grupit për Hulumtimin e Politikave në Ballkan dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SCO-K-së, Danida-së apo KCSF-së.

Mohim i përgjegjësisë:

Qëndrimet dhe analizat në këtë raport janë tërësisht të Grupit Ballkanik dhe nuk reflektojnë qëndrimet e donatorëve.

Balkans Policy Research Group

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTESAVE	6
PËRMBLEDHJE	7
REKOMANDIMET	9
HYRJE	10
METODOLOGJIA	12
SHËNIME MBI PËRDORIMIN E GJUHËS	12
PJESA I: NGËRÇI NË DIALOG	14
MANGËSITË E DIALOGUT TË BRUKSELIT	15
PJESA II: SHQIPTARËT REFUZOJNË	16
ASOCIACIONI I KOMUNAVE SERBE: SHKAKTOI NJË KRIZË TË PAPRECEDENT	17
PSE SHQIPTARËT REFUZUAN	18
ZGJERIMI I PLANIT TË AHTISARIT	19
(JO) KUSHTETUTSHMËRIA E ASOCIACIONIT	20
FRIKA E NDËRHYRJES SË SERBISË NË ÇËSHTJET E BRENDSHME TË KOSOVËS	23
RREZIKU I NJË QEVERISJEJE JOFUNKSIONALE DHE TË NDARË ETNIKISHT	23
KËRCËNIMI I INTEGRITETIT TERRITORIAL DHE SOVRANITET I CUNGUAR	24
PJESA III: ÇKA MENDOJNË SERBËT PËR ASOCIACIONIN	26
DYKUPTIMËSI KONSTRUKTIVE APO DESTRUKTIVE E ASOCIACIONIT?	26
KRIZA NË PRISHTINË: NJË GARË PËR PUSHTET APO LUFTË PËR MËNYRËN E QEVERISJES?	28
ASOCIACIONI: ÇFARË 'FUQISHË EKZEKUTIVE'?	30
ASOCIACIONI SI MJET PËR TË RUAJTUR NJË MËNYRË JETESE	33
HALLKA QË MUNGON: DUKE KËRKUAR NJË UDHËHEQËSI SERBE AUTENTIKE	37
PËRFUNDIME	40
SHTOJCA I: REZULTATET PËR KOMUNAT VERIORE	41
PYETJET E ANKETËS	41
SHTOJCA II: REZULTATET E ANKETËS PËR KOSOVËN QENDRORE	45
PYETJET E ANKETËS	45

LISTA E SHKURTESAVE

AAK	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
AKKM	Asociacioni i Komunave të Kosovës
AKS	Asociacioni i Komunave Serbe
CSM	Bashkësia e Komunave Serbe
EEAS	Shërbimi Evropian për Aksione të Jashtme
BE	Bashkimi Evropian
FDI	Investimet e Huaja Direkte
KPA	Agjencia Kosovare e Privatizimit
LDK	Lidhja Demokratike e Kosovës
NISMA	Nisma për Kosovën
PDK	Partia Demokratike e Kosovës
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
VLAN	Vetevendosje-LDK-AAK-NISMA

PËRMBLEDHJE

Marrëveshja për asociacionin/bashkësinë e komunave me shumicë serbe shënon kulmin e mosmarrëveshjeve të dialogut të lehtësuar nga BE-ja në mes të Kosovës dhe Serbisë. Parimet e Përgjithshme për krijimin e asociacionit/bashkësisë, të arritura me 25 gusht 2015, kanë sjellë më shumë kundërthënie dhe kanë shkaktuar një krizë të paprecedentë në Kosovë. Lthtarët e saj e mbrojtën si një instrument për integrimin e serbëve të veriut të Kosovës në juridiksionin e Kosovës dhe si një avancim drejt normalizimit të marrëdhënieve në mes të dy shteteve. Megjithatë, asociacioni është shndërruar në një çështje të komplikuar në praktikë. Shumë segmente të shoqërisë në Kosovë refuzojnë një asociacion të këtij lloji. Gjykata Kushtetuese gjykoj se marrëveshja për asociacionin është në kundërshtim me frymën e Kushtetutës dhe qeveria, në përgjithësi, është hezituese në zbatimin e saj deri sa Serbia të paraqes plane të qarta për tërheqjen e strukturave paralele të cilat i financon në Kosovë. Serbët e Kosovës e shohin asociacionin nga një pikëvështrim shumë praktik: një shpërbim për integrimin e dhimbshëm në kuadër të ligjeve të Kosovës dhe zëvendësimin e institucioneve të financuara nga Serbia. Ata frikësohen nga reagimet e shqiptarëve që u panë përgjatë 15 muajve të fundit, se ndihen të padëshiruar në Kosovë dhe brengosen që Beogradi do t'i braktisë së shpejti. Komuniteti serb - pala më e prekur nga dialogu dhe më së paku e përfshirë në të - dëshiron që dialogu për normalizim të vazhdojë, marrëveshja e koalicionit të respektohet dhe një tranzicion të lehtë nga sistemi i Serbisë në atë të Kosovës.

Qëndrimet dhe pikëvështrimet e ndryshme të Qeverisë së Kosovës, serbëve të Kosovës, Beogradit dhe të komunitetit ndërkombëtar vetëm sa po i komplikojnë çështjet edhe më shumë. Liderët në Kosovë dhe Serbi e mbështesin marrëveshjen për arsye shumë të ndryshme: ata kanë vetëm makro-objektiva. E para zotohet që të themelojë asociacionin vetëm sa për ta përmbushur zotimin e saj ndaj dialogut të Brukselit, të përmbush integrimin e serbëve dhe të arrijë fazat e fundit të normalizimit me Serbinë. Kjo e fundit dëshiron që Bashkësia e Komunave Serbe t'ju shërbejë serbëve të Kosovës, të transferojë kompetencat e financimit nga Beogradi në një trupë të re ligjore dhe ta përdor si një urë të bashkëpunimit me Kosovën, në kuadër të kornizës së normalizimit të marrëdhënieve. Serbët e Kosovës, në anën tjetër, kanë pikëvështrime mikro dhe dëshirojnë që bashkësia të jetë një mjet praktik që do t'ju ndihmojë në ruajtjen e identitetit, fuqizimit të mjeteve të tyre për t'u marrë me Qeverinë e Prishtinës dhe në ruajtjen e shërbimeve "vitale" të financuara nga Serbia dhe lidhjeve me Beogradin.

Partitë opozitare në Prishtinë, shumë zëra hezitues në qeveri dhe shumica e publikut e shohin asociacionin si një rrezik kundërkushtetues i cili cenon shtetësinë dhe sovranitetin e Kosovës. Kritikët argumentojnë se kushtetuta aktuale ofron mbrojtje të mjaftueshme për komunitetin serb, dhe e shohin asociacionin – siç është paraparë me Marrëveshjen e Brukselit – si të panevojshëm, me rrezikun e shtuar të krijimit të një niveli të tretë të qeverisjes, etnikisht homogjen dhe që do të pengojë integrimin e serbëve në Kosovë. Ata frikësohen se asociacioni më vonë do të shndërrohet në një krijesë të ngjashme me Republikën Serbe në Bosnjë. Qeveria, megjithatë, mbetet e përkushtuar në themelimin e asociacionit, kësaj radhe në kuadër të vendimit të gjykatës kushtetuese dhe insiston se opozita ka motive të tjera prapa reagimeve të dhunshme ndaj marrëveshjes për asociacionin, p.sh. dëshirën për ta rrëzuar koalicionin qeverisës.

Në shikim të parë, serbët duan një bashkësi ngase ajo refuzohet aq shumë nga shqiptarët, kështu që duhet të jetë një gjë e mirë për ta. Beogradi u ka thënë atyre që të insistojnë në bashkësinë dhe mos të bëjnë asgjë derisa Prishtina ta krijojë atë. Në praktikë, serbët janë plotësisht të vetëdijshëm për ambiciet dhe qëllimet konkurruese të Prishtinës dhe Beogradit, në të cilat ata janë shndërruar në subjekt edhe me pajtimin e BE-së. Dykuptimësia e marrëveshjes për asociacionin dhe niveli i kompetencave që i jep komunitetit serb; shumica e përkrahin idenë që asociacioni ka "fuqi ekzekutive" (ide kjo e refuzuar nga shqiptarët), por vetëm disa – nëse ekziston ndonjë i tillë – mund ta përshkruajnë se çka do të ishin këto fuqi në terma praktik. Cilëndo kahje që marrëveshja mund ta marrë, komuniteti serb frikësohet për fundin e shtetit të Serbisë në Kosovë dhe për mënyrën se si kjo do të ndikojë në jetën e tyre të përditshme. Vonesat në themelimin e asociacionit, serbët i shohin si një indikacion të mungesës së vullnetit të Prishtinës për ta akomoduar komunitetin e tyre.

Kundërshtimi i marrëveshjes nga shqiptarët, nuk i ka befusuar serbët. Megjithatë, shkalla e reagimeve ka ngritur shumë shqetësime tek ta. Për disa, kjo reflekton situatën e konsolidimit të ulët të demokracisë në Kosovë, përshfaqë institucionet e dobëta politike dhe i shërben opozitës si një mjet kundër Qeverisë në pushtet. Për shumicën, këto reagime, shpesh edhe të dhunshme, shprehin përcaktimin e shqiptarëve për të refuzuar çfarëdo garancie shtesë për serbët. Peticioni i udhëhequr nga opozita që mbledhi 205,000 nënshkrime dhe dështimi i Qeverisë dhe institucioneve për ta zbatuar marrëveshjen e plotë dhe për t'u ngritur kundër protestave, janë dy politika që shqetësojnë serbët më së shumti. Një pengesë tjetër e madhe për ta është vetë Qeveria e Beogradit, e cila po pengon serbët që ta ngrisin zërin e tyre, të angazhohen apo të prezantojnë politikën e tyre.

Ka dallime të thella dhe të papajtueshme në mënyrën se si shqiptarët dhe serbët i shohin qëllimet e asociacionit. Për komunitetin shqiptar kjo është një çështje fundamentale e sovranitetit dhe shtetësisë. Ata e shohin asociacionin si një ofertë të propozuar nga Beogradi (jo nga serbët e Kosovës) e cila do të shfrytëzohet për ta minuar dhe për ta bërë shtetin e tyre jofunksional. Mënyra se si Beogradi kontrollon serbët e Kosovës vetëm sa e ushqen frikën e tyre. Për ta, Kosova nuk ka fituar asgjë ndërsa Beogradi ka fituar gjithëçka. Për serbët e veriut të Kosovës, veçanërisht, bashkësia e llojit siç është arritur marrëveshja do të ishte shumë më pak se çka kanë ata sot. Ata e kuptojnë këtë si një mënyrë për të mbijetuar pa përkrahjen e Beogradit ngase do të ishin të integruar plotësisht në shtetin e Kosovës. Ata duan që bashkësia t'ju shërbejë vetëm atyre, të ruajnë mënyrën e tyre të jetesës në terma praktik. Mungesa e mirëkuptimit të shqetësimeve të ngritura nga palët është pengesa kryesore për formimin e asociacionit.

Bisedimet për asociacionin mund të fillojnë së shpejti por zbatimi nuk do të ndodh në të ardhmen e afërt. Në mënyrë që asociacioni të themelohet, të funksionojë në mënyrë efikase dhe t'i shërbejë qëllimit, frika dhe shqetësimet e shqiptarëve dhe serbëve duhet të adresohen. Një numër veprimesh dhe hapash përgatitor duhet të ndërmerren. Diskutimet dhe dialogu në nivel lokal dhe në nivel qeverie do të ndihmojnë në largimin e frikës. Qeveria, Kuvendi, serbët e Kosovës të të gjitha pjesëve dhe subjektet politike, si dhe aktorët lokalë duhet të përfshihen në një dialog gjithëpërfshirës për të krijuar një udhërrëfyes për integrimin e plotë të serbëve dhe themelimin e asociacionit. Zyrtarët e Beogradit mund të marrin pjesë por duhet të përmbahen nga pengimi i konsultimeve.

REKOMANDIME

1. Dialogu duhet të vazhdojë dhe marrëveshjet duhet të zbatohen. Komunitetet e veriut duhet të integrohen në plotni, të bashkëpunojnë me qeverinë dhe të respektojnë ligjet, ato duhet t'i bashkëngjiten asociacionit të Komunave të Kosovës. Kosova dhe Serbia duhet të pajtohen për tërheqjen/integrimin e institucioneve paralele serbe (komunave) njëkohësisht me kohën e implementimit të asociacionit.
2. Qeveria duhet ta bëjë dialogun plotësisht transparent, përfshijë të gjitha partitë parlamentare në procesin e dialogut me Serbinë dhe të krijojë mekanizma për konsultime të rregullta.
3. Qeveria dhe ekipi menaxhues duhet të hapin dialogun rreth asociacionit me të gjithë akterët, duke përfshirë opozitën, shoqërinë civile dhe të gjithë komunitetin serb në Kosovë. Ata duhet t'ju ekspozohen pikëvështrimeve dhe kërkesave të të gjitha palëve.
4. Qeveria duhet të prezantojë një udhërrëfyes gjithëpërfshirës për zbatimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe. Udhërrëfyesi duhet të prezantojë procesin, afatet kohore, përmbajtjen dhe mekanizmat e konsultimeve/inpoteve që do të udhëhiqnin formimin e asociacionit. Diskutimet dhe konsultimet duhet të ndodhin në kuadër të udhërrëfyesit. Dialogu do të prodhojë inpote në përmbajtjen e statutit dhe do të kontribuojë në përmirësimin e marrëdhënieve dhe krijimit të besimit të serbëve me qeverinë e Kosovës dhe me përfaqësuesit shqiptarë në Kuvend.
5. Serbët e Kosovës, liderët lokalë dhe përfaqësuesit e komunitetit duhet të lejohen t'i shprehin shqetësimet e tyre tek Qeveria e Kosovës. Qeveria duhet t'i lehtësojë këto diskutime ndërsa Beogradi duhet ta lejojë komunitetin serb që të punojë në mënyrë të pavarur me Prishtinën. BE-ja duhet ta mbështesë këtë iniciativë dhe t'i bëjë presion Beogradit që të përmbahet nga ndërhyrjet.
6. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Zyra Serbe për Kosovën duhet që bashkërisht të përgatisin listën e të gjitha institucioneve serbe dhe punëve që duhet të integrohen në Kosovë.
7. Beogradi duhet të prezantojë planet për tërheqjen e administratës, komunave, kompanive lokale etj., të cilat i financon në territorin e Kosovës.
8. Funkcionalizimi i asociacionit duhet të dalë nga një qasje gjithëpërfshirëse drejt normalizimit të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Normalizimi i marrëdhënieve bilaterale duhet të vendoset në ballë të dialogut në fazat e ardhshme.

HYRJE

Rezultatet e dialogut në mes të Prishtinës dhe Beogradit kanë qenë burim kundërthëniesh që nga fillimi i tij. Kundërshtimet kulmuan me trazira politike të paprecedentë, pas arritjes së marrëveshjes në mes të Kosovës dhe Serbisë për parimet e përgjithshme për themelimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe, të arritur më 25 gusht 2015¹. Shpresat e kosovarëve dhe serbëve që dykuptimësia e Marrëveshjes së parë Kornizë do të qartësohej, u shuan menjëherë pas nënshkrimit. Paqartësia e marrëveshjes kontribuoi në ngritjen e dy interpretimeve të ndryshme lidhur me kompetencat, strukturën dhe rolin që do të duhej të kishte asociacioni. Interpretimet kundërthënëse vetëm sa i kanë rritur pritjet dhe frikën e komunitetit serb dhe atij shqiptar².

Asociacioni ishte një ide jo e pëlqyer në mesin e shumicës shqiptare që kur u nënshkrua marrëveshja e parë në vitin 2013, ndërsa pakënaqësia vetëm sa u rrit pas marrëveshjes së vitit 2015 mbi Parimet e Përgjithshme. Gjetjet e Gjykatës Kushtetuese ishin se shumë nga dispozitat e saj "ishin në kundërshtim me frymën kushtetuese", por në të njëjtën kohë vendosi që asociacioni duhet të themelohet sipas Marrëveshjes së vitit 2013³. Si qeveria ashtu edhe opozita nxituan për të dhënë interpretimet e tyre rreth këtij gjykimi. Opozita e konsideroi marrëveshjen e vitit 2015 si jo kushtetuese dhe kërkoi dorëheqjen e Qeverisë. Kjo e fundit e sheh opinionin e Gjykatës si një kufizim që duhet të merret parasysh gjatë zbatimit të marrëveshjeve të vitit 2013 dhe 2015, por në thelb nuk e sheh si kundër themelimit të asociacionit. Ata vazhdojnë të insistojnë në marrëveshjen për asociacionin por duhet të hedhin më shumë dritë se si do të duket apo se si do të themelohet ai.

Mospajtimet mbi asociacionin (dhe disa marrëveshje të tjera) e vë në rrezik vetë dialogun në mes të Serbisë dhe Kosovës. Zyrtarë të lartë të qeverisë së Kosovës thonë se asociacioni duhet të themelohet në të njëjtën kohë kur Serbia shpërbën institucionet paralele në Kosovë. Shumë të tjerë e lidhin asociacionin me normalizimin e plotë të marrëdhënieve mes dy vendeve. Në anën tjetër, Beogradi kërkon që së pari të ketë progres për asociacionin dhe kërcënon me bllokim të marrëveshjeve të tjera në rast se nuk ndodh implementimi. Një zgjidhje për të tejkaluar këtë situatë është qenësore për të dy komunitetet. Edhe shumë pyetje të tjera në lidhje me aspektet teknike dhe procedurale mbesin pa përgjigje. Ato janë të rëndësishme sepse paraqesin një numër sfidash që meritojnë kujdes të vecantë, mirëpo një numër i dokumenteve dhe raporteve tjera kanë ofruar analiza të tilla. Qëllimi i këtij raporti nuk është dyfishimi i këtyre përpjekjeve, por kontributi në këto diskutime përmes hedhjes dritë mbi arsyet, argumentet dhe emocionet që qëndrojnë prapa qëndrimeve të të dyja palëve. Raporti mëton të qartësojë konfuzionin dhe të inkurajojë mirëkuptim të dyanshëm të shqetësimeve të shprehura nga komuniteti tjetër me qëllim të krijimit të një asociacioni konstruktiv dhe të qëndrueshëm.

Kundërshtimi i shqiptarëve ndaj asociacionit, që përfshinë partitë politike opozitare (dhe disa pjesëtarë të koalicionit qeverisës), pjesëtarë të

1 Parimet e Përgjithshme për Krijimin e Komunave me Shumicë Serbe, gusht 2015

2 Shih Raportin Big Deal 1, BIRN et al., nëntor 2014, <http://bit.ly/29MTlq7>

3 Vendimi i Gjykatës Kushtetuese Nr. K0130/15

shoqërisë civile dhe një pjesë të madhe të publikut të gjerë, ka të bëjë me disa arsye. Ata e shohin këtë marrëveshje si diçka që shkon përtej asaj që Kosova është pajtuar me Planin e Ahtisaarit, dhe frikësohen që kjo mund të çojë drejt një shteti jofunksional dhe të ndarë etnikisht. Ata e perceptojnë këtë si një tendencë të Beogradit për ta shfrytëzuar asociacionin si mjet për të minuar integritetin territorial dhe sovranitetin e vendit. Për dallim, qeveria vazhdon të mbështes themelimin e asociacionin si pjesë përbërëse e dialogut të vazhdueshëm me Serbinë. Komuniteti ndërkombëtar pret që Prishtina të përmbushë obligimet për të cilat është pajtuar sipas Marrëveshjes së Brukselit, ndërsa qeveria shpreson që përmes asociacionit të përmbyllë integrimin e serbëve në sistemin e Kosovës dhe të ndihmojë në përmirësimin e marrëdhënieve mes dy vendeve, Kosovë-Serbi. Serbët e Kosovës janë grupi më i prekur nga themelimi i asociacionit e megjithatë mbesin grupi më i marginalizuar përgjatë gjithë procesit të dialogut. Ata janë skeptik dhe ndjehen të shfrytëzuar nga ana e Beogradit si një kartë negociimi për procesin e integritetit të Serbisë në BE, por gjithashtu mendojnë se Prishtina nuk brengoset për integrimin e tyre dhe se qeveria e Kosovës është jomiqësore ndaj komunitetit të tyre. Serbët shpresojnë që asociacioni të jetë një mjet përmes të cilit ata mund të sigurojnë mbijetesën e komunitetit të tyre të ndarë në Kosovë.

Raporti paraqet një analizë të të gjeturave në tre kapitujt kryesorë. Kapitulli i parë diskuton rreth mangësive të dialogut të Brukselit, i cili përshfaqë më shumë rreth krizës politike të krijuar si rezultat i marrëveshjes për asociacionin. Kapitulli i dytë shtjellon arsyet e refuzimit të asociacionit nga shumica e shqiptarëve të Kosovës. Kapitulli i tretë paraqet një pasqyrë komplekse të perceptimeve të serbëve dhe mënyrës se si ata e kuptojnë marrëveshjen dhe asociacionin si dhe pikëvështrimet e tyre rreth zhvillimeve politike në Prishtinë. Raporti përfshinë rekomandime mbi parimet që do të duhej të udhëheqnin formimin e suksesshëm të asociacionit.

METODOLOGJIA

Ky raport nuk paraqet qëndrimet e Grupit për Hulumtim të Politikave në Ballkan dhe nuk mbështetë pikëpamjet e qeverisë, opozitës apo komunitetit ndërkombëtar për asociacionin. Raporti paraqet një përmbledhje të hulumtimit të bërë përmes metodave të kombinuara kuantitative e kualitative në mënyrë që të kuptohet gjerësia dhe thellësia e opinioneve dhe qëndrimeve që ndërlidhen me formimin e asociacionit të komunave serbe në Kosovë. Raporti ofron rekomandime se si mund të tejkalohen pikëpamjet e kundërta të të dyja palëve sa i përket marrëveshjes për asociacionin.

Raporti mbështetet në disa burime të dhënash të ofruara për këtë analizë. Raporti mbështetet në të dhënat kuantitative të mbledhura përmes anketimit në Mitrovicën e Veriut, Zubin Potok, Zveçan, Leposaviq, Graçanicë dhe komuna të tjera të Kosovës me shumicë serbe. Të gjeturat e anketës janë prezantuar në grafikone të paraqitura në shtojcën e këtij raporti. Të gjeturat e anketës plotësohen nga hulumtimi dhe diskutimet në pesë fokus grupe të mbajtura në komunat e sipërpërmendura me mbi 30 persona të rëndësishëm që kontribuojnë në krijimin e opinionit publik në kuadër të komunitetit serb, përfshirë përfaqësuesë të institucioneve publike (lokale dhe qendrore të Kosovës dhe serbe/paralele), shoqërinë civile, media e të tjerë. Po ashtu janë realizuar intervista individuale me përfaqësuesë qeveritarë, përfaqësuesë të partive politike, shoqërisë civile, krijuesë-opinionesh dhe përfaqësuesë të medias në Prishtinë.

Metodologjia e hulumtimit dallon varësisht nga analiza e pikëpamjeve të serbëve dhe shqiptarëve dhe qëndrimet e tyre për asociacionin, prandaj krahasimet direkte të të dhënave të ofruara në këtë raport duhet të shmangen. Ky punim qëllimisht ka zgjedhur të ofrojë një analizë më të gjerë të perceptimeve të serbëve të Kosovës mbi asociacionin, si përpjekje për të kompensuar mungesën virtuale të politikave dhe raportimeve të tjera mbi qëndrimet e tyre dhe përjashtimin nga procesi i dialogut. Si reagim ndaj qëndrimeve të krijuara në mesin e shqiptarëve se “Serbët po fitojnë gjithëçka”, raporti mëton të hedh dritë mbi atë se çfarë mendojnë serbët për marrëveshjen për asociacionin dhe krizën politike në Prishtinë.

SHËNIME MBI PËRDORIMIN E GJUHËS

Raporti përdor termin Asociacioni i Komunave Serbe, si nocion neutral në mes të dy versioneve të kontestuara pas zgjidhjes së terminologjisë së marrëveshjeve të 19 prillit 2013 dhe 25 gushtit 2015. Asociacioni përdoret duke iu referuar kësaj trupe si shkurtesë. Termet Asociacion apo Bashkësi paraqiten ndarazi nga njëra tjetra kur teksti i referohet deklaratave të responentëve/fokus grupeve, pjesëmarrësve/të intervistuarve, dhe nënkupton përdorimin e njërit apo tjetrit term nga ana e tyre.

Në disa fusha, Grupi për Ballkan largohet nga praktikat e vendosura ndërkombëtare. Agjencitë ndërkombëtare zakonisht u referohen si “shqiptarë të Kosovës” apo “serbë të Kosovës” për t’i dalluar ata nga banorët e Shqipërisë apo të Serbisë; ngjashëm ata flasin edhe për kroatët e Bosnjës apo serbët e Bosnjës. Megjithatë, shumica e personave në fjalë nuk i përdorin këto terme e për shumë nga ta, këto janë terme ofenduese.

Ne e respektojmë këtë ndjenjë dhe i shmangemi kualifikimeve gjeografike aty ku konteksti nuk e kërkon patjetër, p.sh. kur konteksti është i qartë që kur thuhet “serb” u referohet serbëve të Kosovës dhe jo atyre nga Serbia. Ngjashëm, “shqiptarë” u referohet shqiptarëve të Kosovës.

Qytetarët harrojnë të arriturat e dialogut; ne kemi përafëruar veriun shumë me Prishtinën me integrimin e policisë dhe me kontrollin e kufirit.
(zyrtar i Qeverisë)

Asociacioni është çmim për integrimin e Veriut ...
(Zyrtar i Qeverisë)

Me dialogun, bashkësia ndërkombëtare krijoi një krijesë të rrezikshme...dhe ata duhet t'i japin zgjidhje. Ne duhet ta implementojmë vetëm nëse Beogradi heqë dorë tërësisht nga Kosova.
(Zyrtar i Qeverisë)

PJESA I: NGËRÇI NË DIALOG

Dialogu i ndërmjetësuar nga BE, së paku deri më tani, kryesisht është fokusuar në integrimin e komunitetit serb në shtetin e Kosovës dhe në normalizimin e marrëdhënieve në mes Kosovës dhe Serbisë. Arritja e parë kryesore erdhi në prill 2013 me Marrëveshjen e Parë të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve⁴. Deri më 2016, dialogu ka prodhuar marrëveshje në 23 çështje⁵. Si rezultat, Prishtina filloi gradualisht të shtrijë sovranitetin e saj në Kosovën veriore⁶. Por, edhe më tej dialogu vuan nga mbështetja e limituar publike; përkrahja ra edhe më tutje kur u duk se ky dialog po evoluon në një proces të pafund duke mos u pa dritë në fund të tunelit. Marrëveshjet dhe ri-negotiatat e vazhdueshme shpesh proklamohen nga zyrtarët kosovarë, serbë, dhe ata të BE-së⁷. Në vjeshtën e vitit 2016, tensionet mes Prishtinës dhe Beogradit arritën në një pikë shqetësuese. Beogradi vazhdon të përdorë urdhër-arreste të vjetra kundër shqiptarëve sa herë dëshiron që ta shantazhojë Kosovën⁸. Serbia reagoi ashpër ndaj planeve të Qeverisë për të ristrukturuar minierën e Trepçës⁹, derisa Qeveria e Kosovës dështoi të konsultohet me përfaqësuesit serbë, të cilët bojkotuan institucionet pas miratimit të ligjit për Trepçën¹⁰.

Sot dialogu ka perspektivë të limituar. Qeveria e Kosovës është e frustruar dhe e sheh të pakuptimt vazhdimin e dialogut në të njëjtën mënyrë. Beogradi bën minimumin që i nevojitet për të filluar negociatat e saj në hapjen e kapitujve të tjerë për hyrje në BE, sikur u pajtua për telekomin e Kosovës disa ditë para se të nxirrej vendimi në Bruksel. Dhe BE, e ballafaquar me ngecjet e këtij dialogu, sikur e pranon që “ndoshta ka ardhur koha për njohje reciproke të juridiksionit”¹¹.

- 4 Shiko raportin e Grupit Ballkanik, Integrimi i serbëve në Kosovë pas marrëveshjes së Brukselit. 19 mars 2015. Ligji nr. 04/L-199 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Parë Ndërkombëtare të Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë [më tej “Marrëveshja e Parë”], Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. 38 (2013). Marrëveshja e bashkëngjitur në ligjin për ratifikim, mban titull tjetër: “Marrëveshja e parë e parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve” (19 prill 2013).
- 5 “Raport mbi gjendjen në zbatimin e marrëveshjeve të Brukselit: 1 janar – 15 qershor 2016”, raport nga Ministria e Dialogut e Kosovës në BE, 15 qershor 2016, <http://bit.ly/2awR9Ra>.
- 6 Në nëtorin e vitit 2013, për herë të parë, u organizuan zgjedhjet lokale në veri. Katër kryetarët e sapozgjedhur dhe asambltetë komunale u zgjedhën drejtpërdrejt bazuar në ligjin e Kosovës. Kosova veriore sërisht votoi suksesshëm në zgjedhjet parlamentare të qershorit 2014. Strukturat paralele të sigurisë, civilna zaštita, gradualisht u integruan në institucionet e Kosovës, derisa doganat dhe kontrollet e kufijve u rikthyen në dy vendkalimet në veri. Megjithëse ngadalë, një sistem unik i drejtësisë u vendos në gjithë vendin. Serbia ka kthyer kopjet origjinale të regjistrave civile të Kosovës, dhe tani njeh vultat e doganave të Kosovës. Shiko raportin e parë të Big Deal, op. cit. Që nga Marrëveshja e vitit 2013, më shumë se 100,000 serbë të Kosovës janë regjistruar dhe posedojnë dokumente personale identifikimi të Kosovës. Intervistë e Grupit Ballkanik, zyrtar i lartë i Qeverisë dhe anëtar i ekipit të negociatave, Prishtinë, 31 maj 2016.
- 7 Tre marrëveshje janë proklamuar në vjeshtën e vitit 2016: për targarat e makinave, energjinë, dhe telekomin. Edhe pas kësaj, gjithashtu është raportuar për proklamata të tjera për vazhdimin e dialogut për të njëjtat çështje.
- 8 Nehat Thaçi, një drejtor rajonal i policisë së Kosovës në pjesën jugore të Mitrovicës, u arrestua nga autoritetet serbe në një pikë kufitare më 28 shtator 2016 nën akuzë terrorizmi. Arrestimi u bë bazuar në një urdhër-arrest të vitit 2010, i lëshuar nga Gjykata e Lartë e Nishit. Thaçi dyshohej se në vitin 1999 ka dëbuar një familje serbe nga shtëpia e tyre në Lipjan. Thaçi u lirua nga akuzat më 1 nëntor 2016.
- 9 Që nga konflikti i vitit 1998-1999 mes Kosovës dhe Serbisë, miniera e Trepçës është mbajtur në mirëbesim nga OKB-ja. Konkurrenca mes pretendimeve të pronësisë dhe shumë pretendime të kreditorëve janë paraqitur në këto vite, duke krijuar papajtueshmëri të fuqishme mbi të ardhmen e minierës (që ka operuar me kapacitete minimale në periudhën e pas-konfliktit). Në janar 2015, duke u frikësuar nga një bankrotim i minierës së Trepçës, Qeveria e Kosovës shpall planin e saj për të shtetëzuar kompleksin e minierave. Kjo solli një reagim të ashpër nga Serbia, që pretendon se ka në pronësi afërsisht 75% të kompleksit të minierës. Serbia ka paralajmëruar që çdo përpjekje e Kosovës për të marrë minierën nën kontroll do të rrezikonte Dialogun. Në përgjigje, Qeveria e Kosovës njoftoi se do t'i jap Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) më shumë kohë për të ristrukturuar kompleksin. Në tetor 2016, Parlamenti i Kosovës votoi Ligjin për Trepçën për të shtetëzuar kompleksin e minierave, duke e bërë Qeverinë e Kosovës pronaren e 80% të aksioneve. Pas miratimit të Ligjit, deputetët serbë të Kosovës i lanë ulëset e tyre në Parlamentin dhe në Qeverinë e Kosovës, derisa Serbia kërkoi nga Brukseli që Trepça të përfshihet në Dialogun Prishtinë-Beograd.
- 10 Pavarësisht bojkotit të tyre, serbët kundërshtuan ligjin për Trepçën duke e dërguar atë në Gjykatën Kushtetuese. Gjykata vendosi që kërkesa ishte e pabazë. Rezoluta e Gjykatës Kushtetuese për papranueshmëri në rastin Nr. KO118/16.
- 11 Intervistë e Grupit Ballkanik me një zyrtar të BE-së, tetor 2016. Ai paralajmëroi se për ta bërë këtë, Shërbimi Evropian për Veprim të Jashtëm (EEAS) do të kishte nevojë për më shumë mbështetje nga shtetet kryesore anëtare të BE-së. Pas BREXIT, Gjermania ka mbetur e vetme për të bërë presion mbi Beogradin.

MANGËSITË E DIALOGUT TË BRUKSELIT

Që nga fillimi, dialogu i Brukselit u përball me një numër sfidash dhe vazhdon të përballet me pengesa. Me kërkesë të BE-së për t'u angazhuar në dialog, palët limituan pjesëmarrjen me vetëm disa zyrtarë të lartë qeveritar. Kosova u përfshi pa përgatitje adekuate¹², partitë opozitare u përjashtuan dhe detajet e dialogut u mbajtën të fshehura nga publiku. Kuvendi tentoi që në mënyrë retroaktive të legjitimojë procesin duke miratuar një rezolutë pas fillimit të dialogut, por kjo nuk ishte mjaftueshëm për të arritur konsensus politik¹³.

Që nga fillimi, palët prezantuan qëllime diametrikisht të kundërta të normalizimit të marrëdhënieve. Duke përjashtuar njohjen e Kosovës, BE besonte që dy shtetet mund të punonin drejt normalizimit, duke promovuar politikën e "përmirësimit të jetës së njerëzve"¹⁴. Për zyrtarët e Kosovës dhe shumë mbështetës ndërkombëtarë, përveç emrit, "normalizimi i marrëdhënieve", ky dialog nënkupton njohjen.¹⁵ Megjithatë, për Beogradin kjo nënkupton vetëm bashkëpunim më të mirë dhe mbrojtje e komunitetit serb në Kosovë. Të dyja pajtohen që normalizimi është qëllimi, por atë e kuptojnë në mënyra të ndryshme¹⁶.

Dialogu i Brukselit udhëhiqet disi së prapthi. Në praktikën ndërkombëtare, palët fillimisht arrijnë një marrëveshje, parime ligjërish të detyrueshme, dhe pastaj vazhdojnë të negociojnë çështjet teknike dhe praktike së bashku me zbatimin e tyre. Në këto negociata ka ndodhur e kundërta.¹⁷ Në mungesë të një marrëveshjeje bazike ku çështjet praktike mund të bazoheshin, dialogu ka degjeneruar në një diskutim të stërzgjatur pa ndonjë rezultat të theksuar. Zbatimi i ngadaltë dhe selektiv i marrëveshjeve të arritura deri tani, ka vënë në pikëpyetje si formën ashtu edhe drejtimin e dialogut, e gjithashtu edhe vet arsyen.

Dialogu është shpalosur ndërkohë që situata politike veç ishte përkeqësuar në Kosovë. Në sytë e shumë shqiptarëve, dialogu pa mbështetje publike ka dështuar që të prodhojë rezultate, dhe qeveria dështoi ta komunikojë atë te publiku në mënyrë transparente. Kjo krijoi një ambient eksploziv ku një shkëndijë çoi te një krizë politike e paparë ndonjëherë.

12 Shqiptarët pretendojnë që qeveria e tyre dështon të përgatisë dhe negociojë marrëveshje të favorshme për Kosovën, ndërkohë që serbët prezantojnë në tavolinë probleme të shumta, të gjitha lidhur me funksionimin e brendshëm të Kosovës. Intervistë e Grupit Ballkanik, analist i pavarur, Prishtinë, 28 qershor 2016.

13 Një anëtar i partisë në pushtet pajtohet me opozitën që rezoluta është shkelur nga ata që po udhëheqin dialogun dhe ka kontribuar në mosarritjen e konsensusit. Intervistë e Grupit Ballkanik, zyrtar i lartë i LDK-së, Prishtinë, maj 2016.

14 Intervistë e Grupit Ballkanik, zyrtar i lartë i BE-së, Prishtinë, 14-15 qershor 2016.

15 Raporti i Grupit Ndërkombëtar të Krizave "Serbia dhe Kosova: Rruga drejt normalizimit", 19 shkurt 2013.

16 Po aty.

17 "E kundërta po ndodh në Kosovë, ne po negociojmë pa një bazë." Intervistë e Grupit Ballkanik, anëtar i ekipit të negociatave, 31 maj 2016.

Kosova po zhvillon një sistem ligjor të çmendur...me një kushtetutë e cila e prezanton Kosovën si një shtet multietnik dhe me një asociacion të dizajnuar për një grup etnik i cili do të kontrollohet nga një shtet i huaj
(aktivist i shoqërisë civile)

E quajmë 'Zajednica' sepse është krijuar për Beogradin dhe jo për serbët e Kosovës.
(anëtar i Vetëvendosjes)

PJESA II: SHQIPTARËT REFUZOJNË

Organizimi i komunave me shumicë serbe në asociacione, fillimisht, u dakordua në negociatat e Vjenës të cilat përfunduan në vitin 2007 me Propozimin Gjithëpërfshirës për Vendosjen e Statusit të Kosovës (i njohur si Plani i Ahtisaarit). Plani i Ahtisaarit hodhi themelet për pavarësinë e Kosovës dhe krijoi gjashtë komuna të reja me shumicë serbe¹⁸ si një mënyrë bashkëpunimi për qeveritë lokale "në mbrojtjen dhe promovimin e interesave të përbashkëta".¹⁹ Plani, gjithashtu, ju dha të drejtë këtyre komunave që të bashkëpunojnë dhe të formojnë partneritete²⁰, si dhe të formojnë e të marrin pjesë në asociacione që funksionojnë në përputhje me parimet e transparencës²¹. Marrëveshja e Brukselit e vitit 2013 dhe Parimet e Përgjithshme të vitit 2015 janë të ndryshme nga ato si janë paraparë për asociacionet me Planin e Ahtisaarit²². Marrëveshja elaboron krijimin e asociacionit, përmes 22 parimeve të cilat specifikojnë kornizën ligjore, objektivat, strukturën organizative, marrëdhëniet me autoritetet, kapacitetet ligjore, buxhetin dhe mbështetjen, si dhe dispozitat e përgjithshme dhe përfundimtare²³.

Qeveria mbështet krijimin e asociacionit sepse Prishtina, së bashku me Beogradin, e zgjodhën atë si kornizë për zbatimin e disa pjesëve të Planit të Ahtisaarit dhe Marrëveshjes së Brukselit. Dështimi për të krijuar asociacionin do të ishte një shkelje e premtimeve të bëra në Bruksel. Edhe, nëse gjithëçka shkon mirë, qeveria e sheh këtë si një mjet i arritjes së qëllimit të largimit së serbëve nga Beogradi, duke i integruar ata në sistemin e Kosovës dhe për të përmirësuar marrëdhëniet Beograd-Prishtinë. Mund të jetë "fëmija i padashur" i Qeverisë, por ata e shohin si të nevojshme. Asociacioni është pjesë e rëndësishme e dialogut mes Kosovës dhe Serbisë, dhe komuniteti ndërkombëtar qartazi pret që Kosova të vazhdojë dialogun dhe të zbatojë atë çka e ka premtuar tashmë²⁴.

Për opozitën, shumicën e shoqërisë civile, shumë qytetarë dhe krijuesë opinionesh në Prishtinë, Marrëveshja e Brukselit dhe Parimet e Përgjithshme janë të papranueshme. Një kundërshtim thelbësor i asociacionit lidhet me perceptimin që asociacioni do bëhet 'Ahtisaari Plus', pra një shtrirje në rregullimin ekzistues të komuniteteve²⁵. Një kundërshtim i dytë, që tërhoqi vëmendjen e autoritetit më të lartë gjyqësor të Kosovës, ka të bëjë me kushtetutshmërinë e marrëveshjes, për të cilën Gjykata Kushtetuese e

18 Raport i Grupit të Krizave, Nuk ka alternativë të mirë për Planin e Ahtisaarit, 14 maj 2007. Propozim gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës (2007) [më tej "Plani i Ahtisaarit"], shiko bashkëngjitjen në Aneksin III (decentralizimi), faqe 31-32, <http://bit.ly/1Or4O7J>.

19 Plani i Ahtisaarit, op. cit., Aneksi III, § 9.2.

20 Plani i Ahtisaarit, op. cit., Aneksi III, § 9.1.

21 Sipas Planit të Ahtisaarit, "Asociacionet e tilla mund t'ju ofrojnë anëtarëve të vet një numër shërbimesh, duke përfshirë trajnime, ngritje kapacitetesh, asistencë teknike, hulumtime të ndërlidhura me kompetencat e komunës dhe rekomandime politikash." Aneksi III, § 9.2.

22 Parimet e Përgjithshme të Themelimit të një Asociacioni të Komunave me Shumicë Serbe, gusht 2015; Grupi Ballkanik, Integrimi i serbëve në Kosovë pas marrëveshjes së Brukselit, Mars 2015.

23 Parimet e Përgjithshme të Themelimit të një Asociacioni të Komunave me Shumicë Serbe, gusht 2015.

24 Gjermania, për shembull, ja ka bërë të qartë koalicionit VLAN "se Berlioni do të insistojë në vazhdimin e dialogut me Serbinë dhe në zbatimin e zotimeve të Kosovës" nga marrëveshjet e kaluara. Bodo Weber, "Progres i pabërë? Ndërrimi i demokracisë për zgjidhjen e mospajtimeve për statusin e Kosovës," raport i Këshillit të Politikave të Demokratizimit, nëntor 2014, fq. 11.

25 Opozita theksoi se ata nuk janë kundër Dialogut, por ata janë kundër një asociacioni që do ishte një 'Ahtisaari Plus'. Argumenti i tyre është se ka pasur kundërshtim të fortë për Ahtisaarin, por në fund u miratua sepse në kthim të asaj Kosova do të fitonte njohjen. Ata nuk shohin që Serbia do të bëjë lëshime të tjera në shkëmbim për dakordimin e Kosovës për një marrëveshje 'Ahtisaari Plus'. Grupi Ndërkombëtar i Krizave, Kosova: Nuk ka alternativa të mira për Planin e Ahtisaarit, maj 2007.

vendit lëshoi një vendim në fund të vitit 2015.

Duke shtuar në listën e kundërshtimeve, kërcënimi i sovranitetit të Kosovës dhe integritetit territorial, rreziku i një qeverisjeje jofunksionale dhe krijimit të një entiteti të ngjashëm me Republikën Serbe të Bosnjës kanë qenë kritikuar më publike nga kundërshtarët e asociacionit.

Duke i bërë çështjet edhe më komplekse, dykuptimësia e emërimit të saj, si Asociacion (në shqip) dhe Bashkësi (në serbisht) e bën këtë çështje emblematike për mungesën e qartësisë rreth natyrës së vërtetë të entitetit të propozuar²⁶. Kjo ka mundësuar dallime në interpretime, të cilat kanë ushqyer polemika dhe shqetësime si për politikanët ashtu edhe për popullatën. Opozita e quan "Zajednica", një etiketim që tregon ambicien e Beogradit për ndarjen e serbëve nga shqiptarët²⁷.

Ky seksion analizon shqetësimet e lartpërmendura të komunitetit shqiptar për organin e propozuar, në mënyrë që të ilustrohet arsyeshmëria e refuzimit të përhapur për asociacionin, dhe të kuptohet më mirë kriza politike që u shkaktua më pastaj.

ASOCIACIONI I KOMUNAVE SERBE: SHKAKTAR I NJË KRIZE TË PAPRECEDENT

Parimet e Përgjithshme shkaktuan një çarje politike të paparë në politikën e Kosovës, duke shkaktuar një nga krizat më të rënda që nga pavarësia²⁸. Kjo nuk do duhej të ishte befasisëse. Shqetësimet për dialogun kanë dominuar diskursin publik edhe para marrëveshjes. Opozita tashmë kishte paraqitur qëndrimin përfundimtar: refuzim të çfarëdo aranzhimi i cili do t'i ofronte komunitetit serb privilegje dhe kompetenca përtej atyre të përshkruara nga Plani i Ahtisaarit²⁹. Liderët opozitarë kishin paralajmëruar, në Kuvend e edhe në publik, kundër efektit destabilizues që një strukturë kuazi-qeveritare me autoritet ekzekutiv dhe financim të drejtpërdrejtë nga Beogradi do të kishte në funksionimin e një shteti tashmë të brishtë³⁰.

Sidoqoftë, kriza politike e viteve 2014-2016 rezultoi jo vetëm nga mosmarrëveshjet për asociacionin, por në një masë të madhe ishte rrjedhojë e shpresave të thyera të partive opozitare. Në sfondin e humbjes post-zgjedhore të vitit 2014 që, në sytë e opozitës dhe shumë prej mbështetësve të saj, ishte jo kushtetuese dhe përfaqësonte mosrespektimin e vullnetit të qytetarëve për ta larguar qeverisjen e Thaçit dhe PDK-së, marrëveshja u bë një mundësi më shumë për kundërshtimin opozitar kundër qeverisë së formuar. I kja e LDK-së, aleate në koalicionin opozitar VLAN (Vetëvendosje-LDK-AAK-NISMA) tek PDK me qëllim të formimit të qeverisë mbolli farat e urrejtjes së thellë mes partive tjera. Që nga momenti i publikimit të marrëveshjes për asociacionin e komunave serbe, opozita kontestoi

26 Raporti i parë i Big Deal, op. cit.

27 Intervistë e Grupit Ballkanik, zyrtar i lartë i Vetëvendosjes, Prishtinë, janar 2016. Zajednica është përkthimi origjinal i "Asociacionit" në gjuhën serbe.

28 Një analizë e re më e thellë e Grupit Ballkanik për krizën politike do të publikohet në javët që vijnë.

29 "Tendencat e Serbisë, pavarësisht si quhet apo si është emëruar ky organ, është tendencë për të krijuar një mini-parlament, ku komunat delegojnë përfaqësuesit e vet dhe ku delegojnë përgjegjësitë në vendimmarrje dhe ky është kërcënim për Kosovën, sepse krijohet niveli i tretë i pushtetit që quhet administratë, apo niveli i mesëm i pushtetit. Kjo nuk guxon të ndodhë." Lutfi Haziri "Asociacioni i komunave, apo 'mini-parlament' serb?", *Radio Evropa e Lirë*, 22 shkurt 2013, <http://bit.ly/28IZK4r>.

30 Fatmir Limaj: "Themelimi i 'Zajednicës,' kancer brenda Kosovës," *Bota Sot*, 19 dhjetor 2015.

Marrëveshja e prill 2013 [...] krijoi një Ahtisaari Plus duke rritur autoritetet bazë të komunave nga ato të parapara me Planin e Ahtisarit (përfaqësues i opozitës)

Asociacioni nuk paraqet rrezik për sa kohë ju shërben komunave me kompetenca lokale (zyrtar i Qeverisë)

marrëveshjen dhe kërkoi tërheqjen e nënshkrimit të kryeministrit. Por, duke pasur një shumicë të rehatshme prej 86 nga 120 ulëse në Kuvend, PDK dhe LDK refuzuan kërkesat e opozitës për të anuluar marrëveshjen dhe presionin për ta zbatuar atë.

Opozita adoptoi një strategji, duke përdorur masa të përshkallëzuara që nga hedhja e vezëve deri tek hedhja e gazit lotsjellës, për të ndërprerë të gjitha seancat e kuvendit që do të adresonin çështjen e asociacionit. Opozita gëzon mbështetje të gjerë publike në rezistencën e tyre kundër veprimeve të qeverisë për asociacionin. "Gjykimi i paqartë" i lëshuar nga Gjykata Kushtetuese në fund të vitit 2015, lejoi që çdo parti politike ta interpretonte dhe prezantonte marrëveshjen sipas pikëpamjeve të tyre, gjë e cila thelloi edhe më shumë përçarjen politike. Diskursi publik u nda në dy blloqe. I pari, i ndërtuar rreth kampit opozitar, një segment i gjërë i shoqërisë civile dhe publikut, e lexuan vendimin si vdekje e kobshme e ëndrrës për asociacionin, të paktën në formën e parashikuar nga Parimet e Përgjithshme. Kampi tjetër përfaqësonte koalicionin qeverisës, bashkë me simpatitë (e kualifikuara) të komunitetit ndërkombëtar, që morën një qëndrim më të matur. Vendimin ata e kuptuan thjesht se duhet vazhduar me formimin e asociacionit.

Koalicioni qeverisës është i vetëdijshëm për nevojën për të krijuar një mekanizëm më gjithëpërfshirës, në rast se zbatimi i marrëveshjes së asociacionit do të ndodhte shpejt, dhe nëse dëshirohet të shihet fundi i bllokimit institucional në Kosovë. Edhe pse Kryeministri nuk i ka bërë thirrje zyrtare opozitës për t'ju bashkëngjitur ekipit menaxhues i cili do të ishte përgjegjës për zbatimin e marrëveshjes,³¹ ftesa joformale janë bërë. Partitë opozitare ishin të shpejtë në përgjigjen e tyre se nuk do të jenë pjesë e ndonjë grupi mbështetës apo e ekipit menaxhues, sepse kjo do të legjitimonte një qeveri e cila ka humbur legjitimitetin e saj. Megjithatë, Qeveria e Kosovës ndjen presionin për të themeluar një grup ekspertësh me pjesëmarrje më të gjerë të zyrtarëve të qeverisë, partive opozitare, dhe organizatave të shoqërisë civile që do të analizonte vendimin e Gjykatës Kushtetuese me qëllim të krijimit të një kornize të re dhe do të sigurohej se statuti i asociacionit është plotësisht në përputhje me standardet kushtetuese.

PSE SHQIPTARËT REFUZOJNË

Partitë opozitare dhe të tjerët brenda shoqërisë civile, së bashku me shumë krijuesë opinionesh dhe anëtarë të publikut, marrëveshjen për asociacionin e shohin si rezultat të një dialogu jo-legjitim mes dy palëve të pabarabarta për shkak të dështimit të Serbisë që të njohë shtetësinë e Kosovës. Pajtueshmëria e Prishtinës për këtë asociacion, pa marrë parasysh përmbajtjen e saj, shihet si dorëzim ndaj presioneve të Serbisë dhe komunitetit ndërkombëtar, pa ndonjë përfitim të shtuar. Në pikëpamjen e tyre, njohja e Serbisë do të integronte serbët në Kosovë më shumë se çfarëdo asociacioni.³²

31 Intervistë e Grupit Ballkanik, anëtarë të lartë të Vetëvendosjes dhe AAK-së, Prishtinë, 2, 3 dhe 6 qershor 2016.

32 Intervistë e Grupit për Ballkan, anëtar i lartë i AAK-së, Prishtinë, 6 qershor 2016.

ZGJERIMI I PLANIT TË AHTISAARIT

Në kuadër të planit të Ahtisaarit, Kosova duhet të ofrojë garancione të theksuara për komunitetin serb,³³ gjë e cila për shumë kë ishte një koncesion i dhimbshëm. Përveç Vetëvendosjes, të tjerët e trajtuan këtë si një çmim që ia vlen të paguhet sepse shpërblimi final është pavarësia e Kosovës dhe njohja nga shtete të fuqishme.^{34 35} Nën presionin ndërkombëtar, Prishtina pranoi lidhjet mes komunave serbe në Kosovë dhe Beogradit (“lidhjet vertikale”)³⁶. Për më tepër, thirrja për asociacion nën Ahtisaarin ishte riformuluar në asociacione (shumës) për të lejuar themelimin e tyre me qëllim të avancimit të cilësisë së shërbimeve në nivele komunale, bazuar në interesat dhe nevojat e përbashkëta³⁷. Decentralizimi i qeverisjes për krijimin e gjashtë komunave të reja me shumicë serbe³⁸, dhjetë ulëse të garantuara në Kuvendin e Kosovës, drejtimi i një numri të ministrive (Administrimi i Pushtetit Lokal dhe ajo për Komunitete dhe Kthim), krijimi i Këshillit Konsultativ të Komuniteteve në zyrën e Presidentit,³⁹ krijimi i një kanali televiziv publik të ndarë për komunitete minoritare (Radiotelevizioni i Kosovës 2), dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore ortodokse ishin masa afirmative të miratuara për të lehtësuar integrimin e minoritetit serb. Edhe pse janë tejkuluar madje edhe praktika evropiane, këto koncesione ishin parë si të nevojshme sepse dërguan drejt shpërblimit me pavarësinë e Kosovës dhe njohjeve ndërkombëtare⁴⁰.

Kur pyetja për asociacionin doli sërish në dritë përmes marrëveshjes së prillit 2013, vala e parë e kritikës kundër saj ishte me krijimin e ‘Ahtisaari Plus’, duke zgjeruar autoritetet bazë të komunave me shumicë serbe të parashikuara me Planin e Ahtisaarit⁴¹. Opozita pretendoi se, “ne kishim një konsensus të gjerë për Ahtisaarin...marrëveshja për asociacionin nuk është Ahtisaari...është më shumë...ne nuk kemi konsensus për këtë...për të dhënë më shumë...atëherë ne duhet të ulemi dhe të vendosim nëse do të japim dhe për çfarë përfitimesh”⁴². Plani fillestar tashmë lejonte komunitet të bënin partneritete, dhe ligji për vetë-qeverisje lokale përcaktonte mandatet e tyre, duke mos i lejuar ato të delegonin kompetencat e tyre tek një autoritet tjetër më i lartë. Nëse do të ndodhte ky delegim, do të krijohej një nivel i tretë qeverisjeje, jo-ekzistent në kornizën ligjore dhe institucionale të Kosovës⁴³.

Asociacioni i Komunave Serbe nuk mund të jetë më shumë ose më pak se asociacioni i komunave të Kosovës (anëtar i Gjykatës Kushtetuese)

33 Intervistë e Grupit për Ballkan, anëtar i lartë i AAK-së, 6 qershor 2016.

34 Intervistë e Grupit për Ballkan, anëtar i lartë i AAK-së dhe pjesëmarrës në bisedimet e Vjenës, 6 qershor 2016.

35 Idea për një asociacion të komunave tashmë ishte propozuar në kohën e Planit të Ahtisaarit dhe homologët në Qeverinë e Serbisë kërkuar fuqi ekzekutive në disa fusha. Ekipi i Unitetit arriti të mos lejojë këto fuqi për asociacionin, me arsyzhmërinë se kompetencat ekzekutive do gjeneronin nevojën për kompetenca legjislativë.

36 Raporti i Grupit Ndërkombëtar të Krizave, Kosova: Nuk ka alternativa të mira për Planin e Ahtisaarit, maj 2007.

37 Intervistë e Grupit për Ballkan, anëtar i lartë i AAK-së dhe pjesëmarrës në bisedimet e Vjenës, 6 qershor 2016.

38 Komunitet e reja që dolën nga Plani i Ahtisaarit janë: Mitrovica Veriore (popullata: 12139), Graçanica (popullata: 11359), Ranillugu (popullata: 3792), Klllokoti (popullata: 2651), Parteshi (popullata: 1730), Novobërda (popullata: 6923). Për të dhënat mbi popullatën, shiko raportin e Grupit për Ballkan, Integrimi i serbëve në Kosovë pas marrëveshjes së Brukselit. 19 mars 2015, fq.47.

39 Intervistë e Grupit për Ballkan, anëtar i lartë i Vetëvendosjes, Prishtinë, 2 qershor 2016.

40 Intervistë e Grupit për Ballkan, anëtar i lartë i AAK-së, 6 qershor 2016.

41 Intervistë e Grupit për Ballkan, anëtar i lartë i Vetëvendosjes, Prishtinë, 2 qershor 2016.

42 Komente të bëra nga një zyrtar i lartë i NISMA, Prishtinë, maj 2016.

43 Intervistë e Grupit për Ballkan, anëtar i lartë i AAK-së, 6 qershor 2016.

Për të dy palët, vendimi ofroi argumente shtesë në kundërshtitë e tyre, thjesht duke i armatosur ato për vazhdim të betejës dhe duke fortifikuar mbrojtjen/sulmin e tyre
(ekspert i shoqërisë civile)

Vendimi është i dobishëm për Kosovën...do të ndihmojë të formësojë diskutimin për Asociacionin kur ai të zbatohet
(diplomat i lartë perëndimor).

(JO)KUSHTETUTSHMËRIA E ASOCIACIONIT

Grupi i dytë i kundërshtimeve kundër asociacionit të komunave serbe ndërlidhet me kushtetutshmërinë e saj. Në një përpjekje të fundit për të shtensionuar situatën politike, Presidentja Jahjaga referoi Parimet e Përgjithshme të gushtit 2015 në Gjykatën Kushtetuese për rishikim kundrejt dispozitave kushtetuese mbi barazinë para ligjit, të drejtat dhe liritë themelore, dhe të drejtat e komuniteteve dhe anëtarëve të tyre. Ajo shtroi pyetjen për gjykatën kësajsoj: “A janë këto parime dhe elemente në përputhje me frymën e Kushtetutës [...]?”⁴⁴.

Gjykata e rishikoi marrëveshjen “kapitull për kapitull”, duke gjetur të meta në secilën prej tyre⁴⁵. Gjykatësit shpesh nxorën në pah që nuk ka gjuhë specifike që shkelë Kushtetutën, por ka dispozita në kapituj të ndryshëm “që nuk janë në përputhshmëri të plotë me standardet kushtetuese”, dhe citojnë dispozita specifike të Kushtetutës që duhen pasur parasysh kur të përpilohet statuti i asociacionit⁴⁶. Pjesë të medias dhe shoqërisë civile kanë theksuar natyrën e paqartë të vendimit⁴⁷.

Një nga fushat më të paqarta të vendimit të Gjykatës ka të bëjë me diskutimin se çka nënkuptohet me “ushtrim të mbikëqyrjes së plotë”, që është një nga kompetencat e asociacionit. Gjykata pranon dykuptimësinë e këtij termi dhe faktin që nuk ka përputhshmëri midis shprehjeve të përdorura në versionet në gjuhën shqipe dhe serbe të Parimeve të Përgjithshme⁴⁸. Gjykata esencialisht vendosi një kuptim që bie në mes të dy versioneve, duke thënë se “ushtron mbikëqyrje të plotë” nënkupton “të qenit i informuar”⁴⁹.

Gjykata theksoi se Parimet e Përgjithshme, dhe cilido akt ligjor dhe statut që rezultojnë nga to, duhet të jenë në pajtim me nenin 81 të Kushtetutës⁵⁰, që parandalon asociacionin të shkelë të drejtat dhe kompetencat komunale të dhëna nga ligji më i lartë i vendit⁵¹. Konkretisht, komunat janë të kufizuara nga Kushtetuta dhe nuk mund të shmangin rishikimin administrativ të autoriteteve qendrore⁵².

44 Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës KoO130/15, para. 3, 85.

45 Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës KoO130/15, para. 116, 189.4, III.

46 Shiko p.sh. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës KoO130/15, para. 136. Siç thuhet në Parimet e Asociacionit, një organ i ndarë do të përpilojë statutin (§ 21), por qeveria do të nxjerrë një akt ligjor (p.sh. rregullore) që do të inkorporojë statutin. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës KoO130/15, para. 117 (duke cituar Parimet e Asociacionit §§ 2, 21). Gjykata do të rishikojë rregulloren dhe statutin që do të inkorporojë atë, por është detyra e Ekzekutivit të sigurojë që Kushtetuta si dhe “arsyetimet dhe përfundimet” e vendimit ndiqen gjatë procesit të përpilimit. Para. 116, 119. Fillimisht, rregullorja e qeverisë duhet të nxirret brenda fuqive kushtetuese të qeverisë. Para. 124 (duke cituar nenin 93 të Kushtetutës së Kosovës, që i jep qeverisë fuqinë të nxjerrë legjislacionin sekondar, siç janë rregulloret, në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin primar). Në fjalë të tjera, nuk duhet të tejkalojë Kushtetutën ose ligjet e miratuara nga Kuvendi. Ekzekutivi duhet të ketë vëmendje për dispozitat kushtetuese të qeverisjes lokale, të drejtat themelore, dhe lirinë e asociacionit. Para. 127 (duke cituar nenin 12 të Kushtetutës), 128 (duke cituar nenin 21.4), 129 (duke cituar nenin 44); shiko gjithashtu paragrafet 131, 136, 140, 148, 175, 189.4-5, III-IV. Dhe, asociacioni nuk mund të shkelë fuqitë e komunave ose t’i detyrojë të anëtarësohen pa pasur rrugëdalje. Paragrafët 127, 129, 135 (duke cituar nenin 124.4).

47 Raporti i BIG DEAL nga Bodo Weber, “Truku i ngathtë: Pasiguria Kushtetuese, Jostabiliteti Politik dhe Sundimi i ligjit në Dialogun Kosovë-Serbi,” BIRN dhe të tjerë, prill 2016, fq. 12.

48 Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës KoO130/15, para. 143.

49 Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës KoO130/15, para. 144. Ky interpretim ofrohet duke marrë parasysh Marrëveshjen e Parë, që përdorë “të ketë mbikëqyrje të plotë”. § 4.

50 Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës KoO130/15, para. 141 (duke cituar nenin 81 të Kushtetutës); shiko gjithashtu 148, 189.4, 189.5, III, IV. Legjislacioni i “interetit jetik” kërkon një votë nga shumica e deputetëve dhe shumica e deputetëve minoritarë që kanë ulëse të rezervuara. Ligjet që definojnë territoret dhe fuqitë e komunave konsiderohen si interes jetik. Kushtetuta, neni 81.1.

51 Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës KoO130/15, para. 148.

52 Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës KoO130/15, para. 149.

Gjykata shprehu shqetësim mbi strukturën organizative të asociacionit, duke vënë theks mbi menaxhimin dhe punëtorët e saj. Paneli gjyqësor shprehu frikë se minoritetet etnike që jetojnë në komuna me shumicë serbe mund të mos përfaqësohen mirë si në udhëheqësi, struktura dhe pozita pune⁵³. Gjithashtu, gjykatësit theksuan se, bazuar në Marrëveshjen e Parë, asociacioni duhet të ketë strukturë të ngjashme me asociacionin ekzistues të komunave të Kosovës⁵⁴. Punonjësit e tij nuk kanë statusin e shërbyesit civil, status i rezervuar për punëtorët e institucioneve qeveritare⁵⁵. Por, më e rëndësishmja, asociacionit nuk do t'i jepet "autoritet i plotë dhe ekskluziv" mbi komunitetin etnik serb në Kosovë⁵⁶. Asociacioni do të jetë pjesë e Këshillit Konsultativ për Komunitete, por nuk do të minojë fuqitë e tij. Si anëtar, asociacioni mund të sugjerojë propozime legjislative⁵⁷, por nuk ka të drejtë të sjellë ligje në Kuvend, që me Kushtetutë është e rezervuar për Presidentin, Qeverinë, deputetët, ose për të paktën dhjetë mijë qytetarë⁵⁸. Qasja e asociacionit në Gjykatën Kushtetuese është e limituar⁵⁹.

Sipas Kushtetutës, komunat pranojnë transfere të fondeve nga qeveria qendrore për zbatimin e kompetencave dhe aktiviteteve të tyre. Komunitetët kanë të drejtë ekskluzive të vendosin se si do i shpenzojnë fondet⁶⁰, dhe asociacioni nuk mund të minojë të drejtën e komunës për të shpenzuar fondet e alokuara nga qeveria⁶¹. Përdorimi i frazës "ushtrim i mbikëqyrjes së plotë"⁶² në Parimet e Përgjithshme duhet të ndryshohet në "ka mbikëqyrje të plotë"⁶³, ashtu siç ishte sipas Marrëveshjes së Brukselit⁶⁴. Kompetencat e komunave nuk do të mund të transferohen tek asociacioni⁶⁵, dhe nuk do të jetë në gjendje të punësojë personel bazuar në Ligjin për shërbimin civil⁶⁶.

Ne do të konsultojmë të gjitha partitë dhe ekspertët dhe ne nuk do të bëjmë asnjë lëvizje që do të shkojë përtej vendimeve të Gjykatës

(anëtar i qeverisë)

Beogradi po fiton terren në këtë dialog....Ne ndihemi njëjtë si qeveria... kryeqytetet tona nuk po e kuptojnë këtë... (diplomat i perëndimit)

53 Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës KoO130/15, para. 153.

54 Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës KoO130/15, para. 130, 154 (duke cituar Marrëveshjen e Parë § 3). Shiko gjithashtu Statutin e Asociacionit të Komunave të Kosovës (2010) dhe Statutin e Asociacionit të Komunave të Kosovës (2015). Sipas Marrëveshjes së Parë, organizimi i brendshëm i asociacionit serb do të ishte pasqyrë e Asociacionit të Komunave të Kosovës. § 3. Ndryshimet e vitit 2015 në statutin e AKK-së janë jorelevante, sepse ato kanë të bëjnë vetëm me fuqitë e asociacionit. Krahaso Statutin (2010), § 3.2.8 ("krijon fonde, hap zyra përfaqësuese, institucione publike") me Statutin (2015), § 3.2.8 ("hap zyra përfaqësuese, krijon mekanizma për rritjen e kapaciteteve të autoriteteve komunale"). Anëtarët e ekipit të Kosovës në negociatë thonë se në vitin 2013 ata kanë shmangur bisedimet për statutin e AKK-së. Intervistë e Grupit për Ballkan, zyrtar i lartë i qeverisë, Prishtinë, 31 maj 2016. Të tjerët theksojnë se statuti i vitit 2010 ishte jokushtetues. Intervistë e Grupit për Ballkan, specialist i qeverisë lokale, Prishtinë, 25 maj 2016.

55 Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës KoO130/15, para. 156, 159 (duke cituar nenin 101 të Kushtetutës, që definojnë shërbimin civil si pjesë e qeverisë).

56 Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës KoO130/15, para. 166 (duke cituar nenin 57.1 të Kushtetutës që definojnë komunitetet etnike).

57 Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës KoO130/15, para. 171 (duke cituar nenin 60.3(2) të Kushtetutës që definojnë fuqitë e Këshillit Konsultativ për Komunitete).

58 Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës KoO130/15, para. 172 (duke cituar nenin 72 të Kushtetutës që definojnë iniciativën legjislative).

59 Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës KoO130/15, para. 174 (duke cituar nenin 113 të Kushtetutës që definojnë palët e autorizuar para Gjykatës Kushtetuese). Asociacioni mund të mos referojë raste në të njëjtën mënyrë si kanë të drejtë Presidenti, Qeveria, ose Kuvendi. Por, mund të kërkojë korrigjim nëse shkelen të drejtat e tij kushtetuese, ashtu siç ka të drejtë çdo qytetar tjetër ose personat juridik. Vendimi, paragrafi 176 (duke cituar nenin 113.7 të Kushtetutës).

60 Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës KoO130/15, para. 180 (duke cituar nenin 124.5 të Kushtetutës, që definojnë financat e komunave); shiko gjithashtu paragrafat 139, 179, 181, 189.4-5, III-IV.

61 Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës KoO130/15, para. 181 (duke cituar nenin 124.5 të Kushtetutës, që definojnë financat e komunave). Auditori Gjeneral mund të rishikojë financat e asociacionit për sa kohë që ata përfshijnë përdorimin e parasë publike. Paragrafi 182-83.

62 Parimet e Asociacionit. op. cit., § 4.

63 Marrëveshja e Parë, op. cit., § 4.

64 Gjykata Kushtetuese ka interpretuar "të ketë mbikëqyrje të plotë" si "të jetë i informuar" në fusha të politikave të zhvillimit ekonomik, arsimit, shëndetësisë, dhe zhvillimit urban dhe rural. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës KoO130/15, para. 144.

65 Intervistë e Grupit për Ballkan, zyrtar i lartë i qeverisë, Prishtinë, 17 qershor 2016.

66 Qeveria e Serbisë synoi që këto tre kompetencat e fundit kryesore t'i jipen asociacionit. Raport i Grupit për Ballkan, Integrimi i serbëve në Kosovë pas marrëveshjes së Brukselit. 19 mars 2015, thekson: "Pasi që çdo gjë të jetë dakorduar për asociacionin", Beogradi planifikon të miratojë një ligj që i transferon bashkësisë fuqitë që i ka sot mbi komunitetin serb dhe pronat që posedon në Kosovë, duke bërë një vend për këtë entitet në rendin e saj kushtetues." Në këtë skemë, shumica e marrëdhënies Beograd-Prishtinë do të kalonte përmes

Asociacioni do t'i mundësonte Serbisë që të ushtronte ndikim në Kosovë, dhe në fund të fundit të sfidonte funksionimin e shtetit të Kosovës (përfaqësues i opozitës)

Asociacioni do të gjeneronte një sistem jofunksional të qeverisjes, të ndarë në vija etnike

Parimet e Përgjithshme nuk janë tërësisht në përputhje “me frymën e Kushtetutës”.⁶⁷ Qeveria do ta zbatojë po aq sa e lejon Kushtetuta⁶⁸, por rruga nuk është e lehtë për shkak të pengesave politike⁶⁹. Për të dy palët, vendimi ofroi argumente shtesë në kundërshtinë e tyre, thjesht duke i armatosur ato për vazhdimin e betejës dhe duke mundësuar fortifikimin e pozitive të tyre. Blloku ‘jokushtetues’⁷⁰ besoi se parimet janë të pariparueshme⁷¹ dhe se Gjykata Kushtetuese e hodhi poshtë asociacionin duke gjetur se marrëveshja në 23 pika nuk është në përputhje me standardet kushtetuese⁷². Ata konsiderojnë jokushtetues çdo veprim që ndërmerret për themelimin e asociacionit⁷³, duke rezultuar në përfundimin e tyre se qeveria duhet të tërheq nënshkrimin dhe të anulojë Marrëveshjen.

Kryeministri Mustafa ishte i shpejtë për t’ju përgjigjur këtyre thirrjeve, duke thënë qartazi se tërheqja në këtë format nuk do të ndodhë. Koalicioni qeverisës⁷⁴ vendimin e Gjykatës Kushtetuese e lexon ndryshe, duke thënë se duhet të ketë një asociacion⁷⁵. Me ratifikimin e marrëveshjes më 23 qershor të vitit 2013 nga Kuvendi i Kosovës, qasja e qeverisë është se pesëmbëdhjetë dispozitat e Marrëveshjes së Parë janë kthyer në një obligim ndërkombëtar për Kosovën⁷⁶. Si e tillë, marrëveshja duhet të zbatohet, pa marrë parasysh se cila qeveri është në fuqi. Përtej obligimeve ligjore, qeveria është nën presion ndërkombëtar për të vazhduar tutje. Gjatë një fjalimi në Kuvendin e Kosovës, përfaqësuesja e lartë e BE-së Federica Mogherini tha se asociacioni “do të bazohet në vendimin e Gjykatës Kushtetuese, që jep udhëzimet për të siguruar se statuti i asociacionit do të reflektojë ligjet e Kosovës”⁷⁷. Gati pesë muaj pas vendimit, kjo ishte hera e parë që një zyrtar i lartë i BE-së jepte deklaratë lidhur me vendimin e Gjykatës Kushtetuese por duke mos e adresuar paqartësinë e vendimit, deklaratat e Mogherinit mbetet po aq e dykuptimtë sa edhe vetë vendimi. Diskutimet me një zyrtar

bashkësisë si institucioni i vetëm që njihet formalisht nga të dyja. Ky plan është kundër marrëveshjes së Brukselit dhe frymës së normalizimit, që është ajo çka Serbia respekton. Jurisdiksioni i Kosovës mbi territorin e plotë të saj. Qeveria e Kosovës nuk mund të pranojë në territorin e saj ndonjë rol formal të Serbisë, e gjithashtu, qëllimet e Beogradit do të shkelnin ligjet e Kosovës. 39-40.

67 Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës KoO130/15, paragrafi 189.4-5, III-IV.

68 Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës KoO130/15, paragrafi 189.4-6, III-IV.

69 Një raport hulumtues i bërë së fundmi, përshkruan se çka pasoi vendimin e Gjykatës: “Nëse Presidentja Atifete Jahjaga ka shpresuar sinqerisht që dorëzimi i Marrëveshjes së 25 gushtit në Gjykatën Kushtetuese do t’i jepte fund krizës politike, këto shpresa u thyen nga reagimet që pasuan vendimin e 23 dhjetorit, duke reflektuar konfrontimin politik.” Gjykimi u quajt “një vendim konfuz që është i vështirë për t’u lexuar nga një jo-jurist (siç është autori).” Raporti BIG DEAL nga Bodo Weber, op. cit.

70 Blloku ‘jokushtetues’, i përbërë nga Vetëvendosje, AAK, dhe Nisma, argumentet e tyre i nxorrën nga përfundimet e Gjykatës Kushtetuese 189.4 dhe Vendimi III. Përfundimet theksojnë se “Parimet (e elaboruara në Asociacionin e Komunave me shumicë serbe në Kosovë – parimet e përgjithshme/elementet kryesore) nuk janë plotësisht në përputhje me frymën e kushtetuese, Neni 3 [barazi para ligjit], paragrafi 1, kapitulli II [Të drejtat dhe liritë themelore] dhe kapitulli III [Të drejtat e komuniteteve dhe anëtarëve të tyre] të Kushtetutës së Republikës të Kosovës.

71 “Kjo këmishë është grisur në 23 vende. As edhe një njeri i varfër nuk e qep dot. Mund ta qepësh në dy ose tre vende, por jo gjithandej.” Intervistë e Grupit për Ballkan, anëtar i lartë i Vetëvendosjes, Prishtinë, 2 qershor 2016.

72 Intervistë e Grupit për Ballkan, anëtar i lartë i Vetëvendosjes, Prishtinë, 3 qershor 2016.

73 Sipas disave, vendimi shkon edhe më tutje duke hedhur poshtë pjesë nga Marrëveshja e Parë, që nuk ishte subjekt i rishikimit kushtetues. Intervistë e Grupit për Ballkan, anëtar i lartë i Vetëvendosjes, Prishtinë, 3 qershor 2016, dhe anëtarë të lartë të AAK-së, Prishtinë, 6 qershor 2016.

74 Koalicioni qeverisës përbëhet nga partitë qeverisëse LDK, PDK, Lista Serbe, dhe të tjera minoritete.

75 Koalicioni qeverisës është fokusuar në Përfundimin 189.3 dhe Vendimin II, që i referohet Marrëveshjes së Parë dhe në mënyrë eksplicite deklaroi se duhet të ketë një asociacion/bashkësi. Përfundimet theksojnë se “Parimet siç elaborohen në ‘Parimet e Përgjithshme/elementet kryesore – Asociacioni i komunave me shumicë serbe në Kosovë’ nuk janë tërësisht në harmoni me frymën e Kushtetutës, neni 3 (barazia para ligjit), paragrafi 1, Kapitulli II [të drejtat dhe liritë fundamentale] dhe Kapitulli III [të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës”.

76 Koalicioni qeverisës duket që ka ndërtuar pozicionin e tij në Përfundimin 189.5 dhe Vendimin IV. Duke bërë thirrje për përputhje me standardet kushtetuese, blloku ‘vazhdoi’ të lexojë këto provizione si dritë e gjelbër për asociacionin. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës KO130/15.

77 Deklaratë, “Fjalim nga Përfaqësuesja e Lartë/Zëvendës Presidentja Federica Mogherini në Parlamentin e Kosovës”, Prishtinë, 5 maj 2016.

të BE-së në Prishtinë nxjerrin në pah se, sipas leximit të tyre, vendimi i Gjykatës Kushtetuese nuk pengon themelimin e asociacionit në përputhje me Parimet e Përgjithshme, dhe se Qeveria e Kosovës duhet të vazhdojë me zbatimin e tij⁷⁸. Me fjalët e një gjykatësi, vendimi është i thjeshtë, asociacioni nuk mund të jetë ndryshe nga Asociacioni i Komunave të Kosovës⁷⁹.

FRIKA E NDËRHYRJES SË SERBISË NË ÇËSHTJET E BRENDSHME TË KOSOVËS

Nën presionin ndërkombëtar, Prishtina pranoi lidhjet mes komunave serbe në Kosovë dhe Beogradit ("lidhjet vertikale") por refuzoi një institucion që do t'i shoqëronte ato komuna ("lidhje horizontale") e i cili do të krijonte një entitet të ndarë serb⁸⁰.

Partitë opozitare mbesin të bindura se qëllimi i vërtetë i asociacionit nuk ishte asnjëherë integrimi i serbëve në Kosovë. Sipas tyre, asociacioni po bëhet që t'i mundësojë Serbisë që të ushtrojë ndikim në Kosovë dhe të sfidojë funksionimin e shtetit. Blloku opozitar e sheh përfshirjen e Serbisë në caktimin e udhëheqjes së serbëve në Kosovë, manovrat e saj gjatë procesit të dialogut, dhe deklaratat publike të përfaqësuesve të saj e dëshmojnë këtë. Debati i tanishëm për asociacionin i është atribuar detyrimeve të deputetëve serbë ndaj Kryeminsitrit serb Aleksandër Vuçiq më shumë se sa një kërkesë e komunitetit serb.

Një frikë e lidhur me këtë e komunitetit serb të Kosovës është që qeveria serbe do të themelojë një asociacion që ka të drejta për "fuqi shtetërore/komunale" dhe mban një pozitë të një "institucioni rajonal" me një autoritet për të mbikëqyrur dhe kontrolluar zyrtarët e komunave dhe të emëruarit politikisht, që do të limitonte autonominë e komunave veriore dhe kryetarëve të tyre që të veprojnë në mënyrë të pavarur nga Beogradi^{81,82}.

RREZIKU I NJË QEVERISJE JOFUNKSIONALE DHE TË NDARË ETNIKISHT

Një tjetër kundërshtim ka të bëjë me atë se marrëveshja e parë dhe parimet i japin asociacionit fuqi të cilat do gjeneronin një sistem jofunksional të qeverisjes, të ndarë përgjatë vijave etnike. Duke përshkruar këtë jo funksionalitet, termi 'bosnjazim' ka fituar simpati në mesin e aktivistëve politik dhe të shoqërisë civile, duke iu referuar Bosnjës dhe Hercegovinës e ndarë mes strukturave të Federatës dhe të Republikës Srpska, e njohur për qeverisjen e vështirë – në mos të pamundur – të kryerjes së punëve të shtetit⁸³.

Nuk është Ahtisaari... Marrëveshja për asociacionin është shumë më shumë....ne nuk e pranojmë dhe nuk kemi konsensus për këtë. Për Ahtisaarin u pajtuam të gjithë...Nëse duhet të japim më shumë atëherë japim për diçka që është e rëndësishme për ne... (anëtar i opozitës në Kosovë)

Asociacioni është një trampolinë për një strukturë tjetër, fuqitë e së cilës përsëri do të jenë pjesë e negociatave në të ardhmen (anëtar i opozitës)

Tani Serbia do emrin dhe kornizën për asociacionin...më pastaj do e plotësojë atë me shumë më shumë fuqi... (anëtar i shoqërisë civile, Prishtinë)

78 "Ata thjesht duhet ta bëjnë këtë." Intervistë e Grupit për Ballkan, zyrtar i lartë i BE-së, Prishtinë, 14-15 qershor 2016.

79 Intervistë e Grupit për Ballkan, Prishtinë, shkurt 2016.

80 Raport i Grupit të Krizave, Nuk ka alternativë të mirë për Planin e Ahtisaarit, maj 2007.

81 Grupi për Studime Ligjore dhe Politike, Opinioni 1, Zbatimi i Marrëveshjeve të ndërmjetësuar nga BE mes Kosovës dhe Serbisë – një analizë e shkurtër e arritjeve dhe sfidave kryesore, gusht 2014. Fq. 3

82 Në anën tjetër, Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale paralajmëroi se në të ardhmen Serbia do të tundohet seriozisht që të ketë më shumë ndikim mbi asociacionin ose për shkak të përfitimeve të brendshme politike ose ndonjë arsye tjetër, njëra prej tyre që është "kushtëzimi permanent i Kosovës për çdo çështje." Besnik Tahiri, Asociacioni/Unioni: dy emra, dy qëllime, Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale, Prishtinë, korrik 2015, fq. 29.

83 Shiko deklaratën e Driton Bakija në "Frikë nga bosnjazimi i Kosovës përmes asociacionit", Zëri (zeri.info), 19 gusht 2015.

Kjo nuk është një marrëveshje, por është një tjetër keqkuptim (anëtar i shoqërisë civile, Prishtinë)

Nga këndvështrimi i organizatave të shoqërisë civile, Marrëveshja e vitit 2013, de facto krijon një qeveri serbe në Kosovë (asociacionin) me garancione ligjore të cilat janë në kontradiktë me Kushtetutën dhe ligjet e zbatueshme në Kosovë^{84 85}. Marrëveshja e Parë thotë se asociacioni do të ketë mbikëqyrje në fushat e zhvillimit ekonomik, arsimit, shëndetësisë, planifikimit urban dhe rural. Termi “asociacion” është parë nga opozita si një mënyrë për të fshehur kompetencat ekzekutive në strukturën e re⁸⁶, që në kuadër të ligjeve të tanishme në Kosovës do të ishte diku në mes të qeverisjes lokale dhe të asaj qendrore. Opozita e sheh këtë nivel të ri si strukturë mbi komunitatet me shumicë serbe, duke formuar një autoritet rajonal.

Që kjo të ndodhë ligjërisht, Kosova duhet të ndryshojë Kushtetutën e saj dhe një numër ligjesh. Çdo ndryshim i këtij lloji do të nxiste protesta tjera të opozitës; ata tashmë e vënë në pikëpyetje pse Kosova duhet të bëjë ndryshime të brendshme politike dhe ligjore për t’i akomoduar marrëveshjet me Serbinë, ndërkohë që Serbia nuk duket e gatshme të bëjë ndryshime ligjore në anën e saj. Sipas opozitës, Serbia ende nuk i ka zbatuar obligimet e saj nga Plani i Ahtisaarit, si transferimi i fondeve në thesarin e Kosovës, duke lënë mënjanë marrëveshjet e arritura gjatë këtij dialogu⁸⁷.

Ata që e kundërshtojnë asociacionin kanë frikë se ai do të fuqizojë lidhjet e komunitetit serb me Beogradin dhe do i bëjë kuazi-zyrtare, duke e dobësuar vullnetin e serbëve për t’u integruar plotësisht në Kosovë. Me këtë nuk do të realizohet bashkëpunim më i thellë mes institucioneve të Kosovës dhe shumicës së popullatës^{88 89} dhe asociacioni do të forconte qeverisjen e ndarë etnikisht.

KËRCËNIMI I INTEGRITETIT TERRITORIAL DHE SOVRANITETI I CUNGUAR

Shumë shqiptarë nuk i besojnë motivit që fshihet prapa asociacionit, duke u frikësuar se kërkesat e Serbisë ndaj Kosovës nuk do të ndalojnë me themelimin e një strukture me fuqi kolektive dhe institucionale për komunitetin serb. Një pjesë e madhe e opozitës, shoqërisë civile dhe e opinionistëve ndajnë këtë pikëpamje, bashkë me shumë brenda institucioneve qeveritare⁹⁰. Ata e shohin asociacionin si një platformë aterimi për një strukturë tjetër, fuqitë e së cilës përsëri do të jenë pjesë e negociatave në të ardhmen⁹¹. Ata kanë frikë se asociacioni është vetëm hap drejt krijimit të Republikës Srpska në Kosovë.

Në sytë e shumicës së komunitetit shqiptar, asociacioni është vetëm një hap larg asaj që do të paraqiste një kërcënim thelbësor për integritetin

84 Analizë e KIPRED, “Zbatimi i marrëveshjeve të dialogut politik Kosovë-Serbi”, korrik 2013, fq. 10.

85 “Autoriteti ekzekutiv dhe legjislativ në Kosovë është i ndarë në mes të niveleve qendrore dhe lokale, ndërkohë që gjyqësori dhe çështjet e brendshme përbëjnë një nivel të tretë rajonal.” Shiko raportin e Grupit për Ballkan, op. cit., fq. 29-34.

86 Shiko “Konjufca: Asociacioni Kosovën e çon drejt federalizimit”, Koha.net, 2 shtator 2015.

87 Intervistë e Grupit për Ballkan, deputet i opozitës, Prishtinë, 3 qershor 2016.

88 KIPRED, “Zbatimi i Marrëveshjeve të Dialogut Politik Kosovë-Serbi”, korrik 2013. Fq. 10.

89 “Nëse Asociacioni merr të gjitha fondet që ka nevojë nga Beogradi dhe BE-ja, atëherë serbët e Kosovës veriore do të kenë pak nevojë/nxitje për të kërkuar lidhje me Prishtinën.” Leon Malazogu dhe të tjerë., “Integrim apo izolim? Kosova veriore në ngërçin zgjedhor 2014”, analizë, GLOBSEC, 13 shkurt 2014.

90 Intervistë e Grupit për Ballkan, zyrtarë të qeverisë dhe opozitës dhe pjesëtraë të opozitës. Prishtinë, janar-shkurt 2016.

91 Intervistë e Grupit për Ballkan, anëtar i lartë i Vetëvendosjes, Prishtinë, 3 qershor 2016.

territorial të shtetit. Mbikëqyrja e sektorit të policisë dhe e gjyqësorit do të krijonte bazë për një entitet serb autonom në Kosovë⁹². Shtetësia që po merr hov do të çalonte përgjithmonë. Duke parë pasojat në Bosnjën fqinje, opozita përpiket të pengojë materializimin e një skenari të tillë. Për më tepër, kjo do të përbënte humbje të burimeve strategjike, në veçanti kompleksit të minierës së Trepçës dhe liqenit të Ujmanit⁹³.

Kundërshtimi i asociacionit është i bazuar në të kuptuarit se, në vend që të nxis integrimin e serbëve në Kosovë, duke i shtuar asociacionit garancione dhe kompetenca të tjera, aspirata e fshehur e Serbisë është të krijojë një autoritet rajonal të centralizuar i cili në të ardhmen do të sfidonte integritetin territorial dhe sovranitetin e Kosovës.

Bisedimet e Brukselit duhet të ndalojnë me retorikën e cila feston fitoret dhe prezanton humbjet e tjetrit. Të gjitha duhet të jenë në kornizën e përmirësimit, jo në kushtet e dëmtimit të tjetrit.

(lider lokal, Kosovë veriore)

Çka ju nevojitet serbëve më së shumti: Ruajtja e identitetit; Mundësia të jetojnë si një komunitet i ndarë brenda Kosovës; Ruajtja e lidhjeve me Beogradin; Ruajtja e vendeve të punës, sigurimit social, sigurimit shëndetësor, të financuar nga Beogradi; Ruajtja e sistemit serb të arsimit; Ruajtja e shërbimeve shëndetësore serbe brenda Kosovës

(aktivist i shoqërisë civile, Mitrovicë veriore)

92 Shiko deklaratat e Driton Çaushit në "Opozita mobilizohet kundër asociacionit", *Zëri* (zeri.info), 19 gusht 2015.

93 Intervistë e Grupit për Ballkan, anëtar i lartë i Vetëvendosjes, Prishtinë, 3 qershor 2016.

Shqiptarët po luftojnë për pushtet, dhe kur vjen puna të serbët, ata janë të bashkuar (përfaqësues serb nga veriu)

Ne nuk po brengosemi për protestat... peticioni me 205,000 nënshkrime është një rrezik...kjo do të thotë se 205,000 shqiptarë janë kundër nesh... (aktivist i shoqërisë civile, Zubin Potok)

PJESA III: ÇKA MENDOJNË SERBËT PËR ASOCIACIONIN

Serbët e Kosovës janë komuniteti më i prekur nga krijimi i një asociacioni me komuna serbe, por ata janë gjithashtu grupi më i marginalizuar në procesin e dialogut të Brukselit. Ata nuk përfaqësohen në tavolinën e negociatave, derisa informatat në dispozicion për procesin janë të limituara, dhe debati publik brenda komunitetit për asociacionin nuk ekziston. Hulumtimi për motivimin, shqetësimet, dhe dëshirat e serbëve lidhur me asociacionin ishin neglizhuar për shumë kohë, duke rezultuar me mungesë të madhe të informatave. Analiza e prezantuar në vijim përbën një përpjekje për të ofruar më shumë informata në lidhje me qëndrimet e komunitetit serb.

DYKUPTIMËSIA KONSTRUKTIVE APO DESTRUKTIVE E ASOCIACIONIT?

Shprehja 'dykuptimësi konstruktive' u sajua për të përshkruar situata në të cilat lënia hapësirë për kuptime ose interpretime të ndryshme të një marrëveshjeje mund të ndihmonte në arritjen e një marrëveshjeje e cila, *përndryshe*, do ishte e pamundur të arrihej. Ideja është që marrëveshja fillestare të krijojë rregulla dhe mundësi për bashkëveprim, që më pastaj të zbusë mospajtimet fillestare dhe më vonë të bëjë të mundshme një marrëveshje më konkrete. Në vitin 2013, dy vjet pasi që filluan negociatat teknike mes Beogradit dhe Prishtinës, mbështetës të dialogut politik mes dy armiqve shpresuan që ky do ishte rasti për zgjidhjen e rebusit ballkanik. Por, për dallim nga shpresat, siç demonstroi ky hulumtim, dykuptimësia e dialogut të Brukselit dhe marrëveshjeve të arritura në kuadër të kësaj kornize kanë marrë një kahje destruktive.

Gjuha e paqartë përshkon të gjitha fushat e komunikimit sa i përket procesit të Brukselit dhe rezultateve të tij. Ndërkohë që Qeveria e Kosovës është munduar të sigurojë votuesit e saj se asociacioni i komunave me shumicë serbe do të jetë thjeshtë një organizatë jo-qeveritare, udhëheqësia e Serbisë ka tentuar të sigurojë serbët e Kosovës me pretendime që, edhe pse në kuadër të sistemit të Kosovës, asociacioni do të ketë fuqi ekzekutive⁹⁴. Retorika e fitores e përdorur nga njëra palë nuk lehtëson frikën dhe shqetësimet e palës tjetër. Përkundrazi, duket si një taktikë kundërproduktive; shkathtësia e njëres anë për të deklaruar triumf përkthehet si humbje për anën tjetër⁹⁵. Këto dallime në karakterizimin e procesit, bashkë me dykuptimësinë e dispozitave të veçanta të marrëveshjes së gushtit (e diskutuar në detaje në seksionin e mëparshëm), kanë krijuar një situatë të rrezikshme që shton frikën mes serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës⁹⁶.

Ndërkohë që serbët e Kosovës janë të dyshimtë ndaj udhëheqësisë serbe,

94 Fokus grup, Zvečan, 19 maj 2016; Fokus grup, Zubin Potok, 19 maj 2016; Fokus grup, Leposaviq, 8 qershor 2016; Fokus grup, Graçanicë, 22 qershor 2016.

95 "Të gjithë janë të bindur që ata hoqën dorë më së shumti, por në fakt serbët e Kosovës humbën më së shumti." Fokus grup, Graçanicë, 22 qershor 2016. "Bisedimet e Brukselit duhet të ndalojnë me retorikën që feston fitoret dhe prezanton humbjet e tjetrit. Të gjitha duhet të jenë në kornizën e përmirësimit, jo në kushtet e dëmtimit të tjetrit. Çka kemi pasur këtu ishte një konflikt mes dy popujve, dhe jo dy politikanëve dhe është shumë e rëndësishme çka njerëzit ndjejnë, jo politikanët.", Intervistë e Grupit për Ballkan, ish-kryetari i një komune serbe, 17 qershor 2016.

96 "BE ka lejuar, që pas përfundimit të raundeve të negociatave, të ketë komunikim plotësisht kundërthënës me publikun.", intervistë e Grupit për Ballkan, konsulent i pavarur, 20 maj 2016.

dhe dyshojnë se Beogradi po e tregton të ardhmen e tyre në shkëmbim të integritit të Serbisë në BE⁹⁷, mediat serbe – duke u ushqyer me informata nga Qeveria e Serbisë – mbasin burimi kryesor dhe më i besuar për serbët e Kosovës sa i përket informatave rreth zhvillimeve për asociacionin dhe për dialogun e Brukselit. Sipas rezultateve të anketës, 22% e serbëve që jetojnë në Kosovën veriore konsiderojnë se Qeveria e Serbisë është burimi më i besueshëm për procesin, ndërkohë që 37% mendojnë se mediat serbe janë burimi më i besueshëm⁹⁸. Kjo është pak më ndryshe në Kosovën qendrore ku mediet serbe mbasin burimi më i besueshëm (29%), por në opinione për besueshmëri Qeveria e Kosovës (24%) dhe liderët lokalë (17%) janë përpara Qeverisë së Serbisë (13%)⁹⁹. Dallimet rajonale mund të shpjegohen për nga niveli më i madh i integritit të komunave me shumicë serbe në Kosovën qendrore, dhe lidhjet e fuqishme të veriut me Serbinë. Është e rëndësishme të theksohet se serbët e Kosovës e kuptojnë që Beogradi mund të thotë atë çka ata, sidomos ata në veri, duan të dëgjojnë¹⁰⁰. Megjithatë, të pranuarit plotësisht e kësaj të vërtete do të thotë të pranuarit e perspektivës së zymtë për ta dhe rëndësisë së tyre politike, ekonomike dhe kulturore në Kosovë, ata vazhdojnë të mbështeten në atë çfarë ju thotë Beogradi me shpresë se ajo mund të jetë e vërtetë¹⁰¹.

Situata në të cilën ndodhen serbët e Kosovës është komplikuar edhe më tej me disponueshmërinë e ulët të informacionit në përgjithësi, pa marrë parasysh saktësinë apo besueshmërinë e tij. Vakumi informativ dhe mungesa e dukshme e transparencës u citua përgjatë katër fokus grupeve si mangësi kryesore në krijimin e asociacionit¹⁰². Pak optimizëm për të ardhmen e asociacionit vjen nga sektori i shoqërisë civile, por edhe kjo nuk është në gjendje të plotësojë hapësirat e lëna nga mediat dhe vendim-marrësit relevantë¹⁰³. Duke u ndjerë sikur zëri i tyre po injorohet dhe se mund të shihet si bezdisje nga liderët politikë (serbë, kosovarë, apo BE) që po ndjekin agjendat e tyre, serbët e Kosovës reagojnë duke hequr dorë nga çfarëdo debati publik potencial për temën¹⁰⁴. Ata ndihen të braktisur, të tradhtuar, të zhgënjyer, të pashpresë¹⁰⁵. Ata “ranë në gjumë në një shtet, e u zgjuan në një tjetër,”¹⁰⁶ duke mos u drejtuar nga dikush nëpër këtë proces.

Nevoja për informacione është e dukshme¹⁰⁷, por përjashtimi i serbëve të Kosovës në diskutim është provë për serbët lokalë se marrëveshja iu shërben elitave politike në Beograd dhe Prishtinë, e jo qytetarëve të rëndomtë¹⁰⁸. Duke parë mungesën e progresit në zbatimin e dy marrëveshjeve, bashkë me dykuptimësinë e paramenduar dhe intepretimet kontradiktore, serbët vijnë në përfundim se nuk ka vullnet politik në asnjërën anë që dispozitat e

Qytetarët janë të distancuar nga zhvillimet, ngase ne nuk jemi integruar ende, por sa më shumë që i afrohem Prishtinës, shohim më shumë reagime nga shqiptarët...

(anëtar i komunës paralele, Zveçan)

Dialogu nuk është duke na ndihmuar. Deri së fundmi, liderët lokalë së paku kanë qenë tanët...tani, ne nuk shohim askënd duke punuar për ne – as Prishtinën, as përfaqësuesit serbë e as Beogradin

(lider lokal i komunitetit, Llapnasellë)

97 Raport i Grupit për Ballkan, Integrimi i serbëve në Kosovë pas marrëveshjes së Brukselit, 19 mars 2015.

98 Anketë e Grupit për Ballkan: përgjigjuni pyetjes “Kush ju ka dhënë informatat më të sakta për asociacionin deri tani?” Kjo mbështetet nga rezultate të ngjashme të marra nga Kossev në një anketë për procesin e Brukselit në të cilën 65% e popullatës ka marrë informacione nga politikanët dhe mediat serbe, qershor 2016.

99 Anketë e Grupit për Ballkan, qershor 2016.

100 Fokus grup, Zubin Potok, 19 maj 2016

101 Fokus grup, Zveçan, 19 maj 2016.

102 “Asgjë nuk dihet për asociacionin, asgjë nuk po bëhet. Procesi nuk është transparent, asgjë nuk dihet dhe mediat nuk raportojnë.” Fokus grup, Leposaviq, 8 qershor 2016.

103 Fokus grup, Mitrovicë, 18 maj 2016.

104 Fokus grup, Mitrovicë, 18 maj 2016; Fokus grup, Zveçan, 19 maj 2016.

105 “Anketa: Šta mislite o Briselskom sporazumu?”, Kossev, 2016, <http://kossev.info/anketa/7/rezultati>

106 Intervistë e Grupit për Ballkan, përfaqësues i institucioneve serbe në Kosovë, 22 maj 2016.

107 “KoSSev është njëra prej gjërave më të mira që ju ka ndodhur serbëve në veri sepse objektivi i informacionit për sistemin e Kosovës,” intervistë e Grupit për Ballkan me një aktivist social, 17 maj 2016.

108 Fokus grup, Graçanicë, 22 qershor 2016; “Neve na duhet ‘debat kafiterie’ e jo debat me ndërmjetësues.” Intervistë e Grupit për Ballkan, përfaqësues i serbëve të Kosovës, Graçanicë, 20 maj 2016

Është e çuditshme, shqiptarët reagojnë ndaj një organi i cili neve do të na integronte në shtetin e tyre...ata e refuzojnë këtë...a është kjo shumë e mirë për neve?

(Përfaqësues serb, Kuvendi i Kosovës)

Ne nuk do të vendosim se çka është mirë për ne... Beogradi dhe Prishtina do të vendosin për ne (serb lokal, Mitrovicë veriore)

nënshkruara në Bruksel t'i bëjnë realitet në terren¹⁰⁹.

Frika, përshtjellimet dhe tensionet e përkeqësuar nga qasja 'dykuptimësia konstruktive' për integrimin e serbëve në sistemin e Kosovës dhe asociacioni e bëjnë frazën "destruktive" të duket më e saktë. Një debat i fundit mes analistëve dhe gazetarëve politikë nga Kosova qendrore dhe veriore sugjeroi se *çështjet e punëve shtetërore janë më ngjashëm me 'jo-normalizimin e marrëdhënieve' se me çdo gjë tjetër. Rezultatet e këtij hulumtimi e mbështesin këtë. Siç u tha nga një pjesëmarrës në fokus grup, "kjo nuk është një marrëveshje, ky është një tjetër keqkuptim"*¹¹⁰.

KRIZA NË PRISHTINË: NJË GARË PËR PUSHTET APO LUFTË PËR MËNYRËN E QEVERISJES?

Trazirat e provokuara nga marrëveshja për asociacionin e komunave serbe gjatë vitit të fundit u janë atribuar përplasjeve në mes të interpretimeve kundërthënëse lidhur me implikimet e marrëveshjes në mënyrën e qeverisjes në Kosovë. Jashtë dhe brenda Kuvendit, qeveria dhe opozita në Prishtinë janë ballafaquar me njëra tjetrën rreth kompetencave të asociacionit, përkatësisht nëse asociacioni i propozuar e ndryshon rendin kushtetues të Kosovës dhe krijon një nivel të tretë të qeverisjes. Përderisa çështja është përplot me ngatërresa politike e ligjore, kur shikohet nga larg, serbët e Kosovës përshkruajnë një pasqyrim tjetër të krizës që po zhvillohet në Prishtinë.

Duke vënë në pikëpyetjet motivet e vërteta, pjesëmarrësit e fokus grupeve, pothuajse njëzëri, u pajtuan se mospajtimet janë të drejtuara nga qëllime të tjera nga ato të paraqitura publikisht. Ka të tillë që besojnë se edhe pse asociacioni ka nxitur krizën, qëllimi i opozitës për largimin e qeverisë ka qenë çështje e nxehtë edhe para tij.¹¹¹ Duke pasur parasysh kushtet e vështira në Kosovë, kauzat nacionale mundësojnë orientimin e frustrimit dhe mobilizimin e përkrahjes popullore për ndryshim.¹¹² Shkëputja e perceptuar e serbëve, e personifikuar përmes asociacionit, ka ofruar një mundësi për protesta kundër gjendjes së përgjithshme në vend dhe kundër qeverisë, e cila nuk ka përmirësuar kushtet e jetesës.¹¹³ Kjo i ka mundësuar opozitës, e posaçërisht Vetëvendosjes, që "të fitojë poena politike në vend se të dëshmojë një rezistencë të vërtetë."¹¹⁴

Megjithatë, për vetë asociacionin, sipas komunitetit serb, si qeveria ashtu

109 Fokus grup, Leposaviq, 8 qershor 2016.

110 Fokus Grup, Graçanicë, 22 qershor 2016.

111 Intervistë e Grupit për Ballkan, zyrtar serb i Kosovës, 11 qershor 2016. "Besoj që bashkësia dhe demarkacioni nuk janë shkaqet, por po përdoren vetëm si temë e mirë për luftë kundër qeverisë. Para së gjithash, aktiviteti i tyre është kundër Qeverisë së Kosovës. Nuk ka arsytim për qeverinë që nuk e ka bërë këtë". Qeveria ka shumicën absolute në Kuvend, prandaj pakënaqësia e opozitës nuk është vendimtare në përmbylljen e çështjes së Bashkësisë. Intervistë e Grupit për Ballkan me zyrtar serb të veriut të një komune të financuar nga Serbia. "Pse shumica e shoqërisë shqiptare e sheh bashkësinë si një kërcënim? Kështu është krijuar atmosfera në mesin e partive politike."

112 "Diskursi në mes të serbëve dhe shqiptarëve paraqitet si problem nga ata që duan të zhvendosin vëmendjen nga problemet reale". Intervistë e Grupit për Ballkan me zyrtar komunal të Zubin Potokut, 17 maj 2016. "Shkaku kryesor i krizës është se Kosova edhe pas kaq shumë vitesh nuk ka arritur një zhvillim të qëndrueshëm megjithëse ata kanë menduar që do të ketë një shpërthim ekonomik pas shpalljes së pavarësisë dhe me ardhjen e investimeve të huaja direkte. Nuk ka investime të huaja, donacionet janë në rënie dhe shoqëria kosovare befasi ka zbuluar se nuk janë duke shkuar saktë në rrugën që kishin planifikuar." Intervistë e Grupit për Ballkan, përfaqësues serb i institucioneve të Kosovës, 22 maj 2016.

113 Intervistë e Grupit për Ballkan, përfaqësues serb në institucione të Kosovës, 22 maj 2016..

114 Fokus grupi në Mitrovicë, 18 maj 2016.

edhe opozita po mundohen që të arrijnë të njëjtin qëllim. Ata e shohin si një interes dhe përpjekje të përbashkët për të gjitha palët në Kosovë për të siguruar që asociacioni të mos jetësohet¹¹⁵. Megjithatë, duhet përmendur se një kritikë e tillë është adresuar edhe ndaj Beogradit¹¹⁶.

Për dallim nga përgjigjet në fokus grupe, rezultatet e anketimit tregojnë se më shumë se 40% e respondentëve në veri të Kosovës besojnë se burimi i vetëm i krizës politike në Prishtinë është marrëveshja për asociacionin. Gati 30% e tyre besojnë se kriza vetëm pjesërisht është shkaktuar nga asociacioni. Për serbët që jetojnë në Graçanicë dhe në komunat e Kosovës qendrore, pothuajse të gjithë (80%) e shohin krizën si rezultat i dalë nga mosmarrëveshjet mbi asociacionin. Edhe anketa e edhe diskutimet në fokus grupe tregojnë se pikëpamjet e serbëve në jug të lumit Ibër janë përkeqësuar në 24 muajt e fundit. Sa më afër ngjarjeve që janë serbët, aq më shumë ndikohen pikëpamjet e tyre, siç ilustron nga serbët në jug të lumit Ibër, shumica e të cilëve, preferojnë integrimin e plotë dhe marrëdhënie stabile me shqiptarët.

Të kuptuarit se “faktori serb” është vendosur në qendër të vëmendjes në një krizë të perceptuar si “brenda-shqiptare”, i shqetëson serbët e Kosovës. Ata mendojnë se Prishtina i frikësohet çfarëdo iniciative e cila serbëve do t’ju sillte edhe dobinë më të vogël, për shkak të frikës nga shqiptarët dhe krijimit të një sistemi të ndarë të qeverisjes¹¹⁷. Përpjekja për t’ju hequr frikën shumicës shqiptare duke shpjeguar se asociacioni nuk përbën kërcënim është e kotë¹¹⁸. Serbët mendojnë që ata shihen si kurban i shumicës së problemeve të komunitetit shqiptar¹¹⁹. Përderisa kjo taktikë mund të jetë e përshtatshme politikisht, kjo ndërhyrje në ndërveprimet njerëzore në nivel të komunitetit, duke e sfiduar gatishmërinë e tyre për t’u angazhuar me njëri-tjetrin dhe në fund të fundit duke cenuar perspektivën e pajtimit. Disa pjesëmarrës të fokus grupeve kanë vërejtur se marrëdhëniet në mes të serbëve dhe shqiptarëve në komunitetet ku jetojnë pranë njëri-tjetrit, siç është rasti në Graçanicë, kanë shënuar përkeqësim pas krizës politike në Prishtinë¹²⁰.

Shqetësimi i nxitur nga toni dhe retorika e krizës është reflektuar në rezultatet e anketimit të zhvilluar për qëllime të këtij hulumtimi. Shqetësimi është emocioni reagues që dominon në katër komunat në veri lidhur me ngjarjet në Prishtinë (46%), ndjekur nga ndjenjat e frikës (21.2%) dhe shprehje nervozizmi (19.3%). Situata është kthyer mbrapsht në Kosovën qendrore ku ndjenja e frikës mbizotëron (45%), pastaj është shqetësimi (24.8%) dhe reagimet e tjera (18.3%).

115 “Publikisht ata janë kundër njëri-tjetrit, por qëllimi është i njëjtë, pra që bashkësia të mos formohet”. Fokus grupi në Leposaviq, 8 qershor 2016.

116 Po aty. “Qeveria aktuale në Serbi nuk ka interes në formimin e bashkësisë, ngase përderisa situata vazhdon kështu siç është, mund të sjell vota nga Kosova, e edhe këto vota janë të vjedhura.”

117 Disa shkojnë aq larg sa që thonë se “problemi i vetëm në Prishtinë është mbiemri “srpska”, “pa marrë parasysh a kanë bazë reale për shqetësim. Fokus grupi në Graçanicë, 22 qershor 2016.

118 “Ju mund të keni miliona argumente se pse bashkësia duhet të ekzistojë dhe pse nuk do ta lëndojë Kosovën, pse nuk rrezikon shqiptarët, e gjitha është për asgjë...nuk mund të gjendet asnjë shqiptar që të thotë “po, bashkësia duhet të ekzistojë dhe njerëzit duhet të kenë një lloj autonomie ngase ata janë kështu si janë”. Intervistë e Grupit për Ballkan me përfaqësues serb të institucioneve të Kosovës.

119 “Çdo konflikt i brendshëm në mesin e shqiptarëve rikthehet në anën e serbëve, një protestë është shndërruar në diçka fatale për serbët.” Fokus grupi në Zubin Potok, 19 maj, 2016.

120 Fokus grupi në Graçanicë, 22 qershor 2016. “Sa herë që diçka të jetë duke u gatuar politikisht, gjithmonë reflekton edhe në marrëdhëniet më bazike në mes të serbëve dhe shqiptarëve. Tani, askush në recepsionin e komunës apo të administratës tatimore nuk dëshiron të flas serbisht apo të ofrojë dokumente në gjuhën serbe. Administrata tatimore në veçanti insiston në përdorimin e gjuhës shqipe”. Sipas ligjeve të Kosovës, të gjitha dokumentet ligjore dhe administrative duhet të jenë të qasshme për publikun në gjuhët shqipe dhe serbe.

Ne do të dëshironim të kishim një Republikë Serbe, por nuk mund ta bëjmë këtë, edhe nëse po, Beogradi nuk do të na linte ta kishim

(përfaqësues serb nga veri)

Gjykata Kushtetuese nuk do të punojë kundër shqiptarëve... gjithmonë do të na kufizojë neve...ne duhet ta dimë këtë që nga fillimi

(deputet serb i Kuvendit)

Ne nuk pretendojmë se e dimë të vërtetën...Realiteti është se Beogradi po na shtyen drejt integritetit (përfaqësues lokal, Zubin Potok)

Ne përballemi me shumë pengesa nga Prishtina...Unë as nuk mund të marrë një kartë identiteti (përfaqësues lokal nga Zubin Potoku)

Analizat dhe rezultatet tregojnë se ekziston një shkallë e lartë e ndjeshmërisë në mesin e serbëve të Kosovës për mënyrën se si elita politike e shumicës shqiptare i adreson çështjet ndër-etnike. Përderisa instrumentalizimi politik është pjesë e lojës politike edhe në demokracitë e zhvilluara, elitat duhet të jenë të kujdesshme për të mos çuar balancën edhe ashtu fragjile të marrëdhënieve ndër-etnike në Kosovë drejt një rruge shkatërruese.

ASOCIACIONI: ÇFARË 'FUQISH EKZEKUTIVE'?

Pasiguria që rrethon pyetjen rreth kompetencave të asociacionit është thelbi i problemit që ka shkaktuar dëme të mëdha në strukturat shtetërore të Kosovës dhe në marrëdhëniet midis komuniteteve të saj. Asnjë çështje nuk ka shkaktuar më shumë shqetësime apo debate se sa ai për "kompetencat ekzekutive" për asociacionin, përkundër faktit se Parimet e Përgjithshme nuk përmendin asnjëherë këtë shprehje. Liderët opozitarë paralajmërojnë se fuqitë ekzekutive pashmangshëm çojnë në krijimin e një Republike Serbe në Kosovë. Shumica e serbëve mbesin shumë skeptik për sa i përket mundësisë që kjo trupë të marrë ndonjëherë ndonjë kompetencë domethënëse. E përderisa virtualisht, të gjithë pjesëmarrësit serbë në hulumtim kanë shprehur dëshirën e tyre që asociacioni të ketë fuqi ekzekutive, shumica nuk kanë qenë në gjendje që të sugjerojnë e përcaktojnë se cilat do të ishin ato në praktikë.

Kritikat e shqiptarëve se asociacioni do të ishte një Republikë Serbe e re, kanë qenë që nga fillimi, mirëpo serbët janë të vetëdijshëm që shkalla e izolimit të strukturuar dhe e ndarjes siç ekziston në Bosnje dhe Hercegovinë nuk do të rivendoset në Kosovë¹²¹. Megjithatë, shumë nga ta presin që asociacioni të jetë diçka, që nuk mund të ndodhë kurrë – një zëvendësim i Serbisë, siç ishte ajo dikur¹²². Por, laramania e pikëpamjeve për këtë çështje vetëm sa reflekton mbi kompleksitetin e situatës. Në listën e dëshirave se si do të donin të ishte asociacioni, serbët e Kosovës kanë gjithçka, që nga të qenit një trupë politike për të orientuar zërin dhe kërkesat e serbëve drejtuar institucioneve qendrore (të Kosovës)¹²³, deri tek një strukturë për autonomi politike nga institucionet e Kosovës, e deri tek një asociacion që shërben si një mekanizëm këshillëdhënës dhe avokues për ligjet që ndikojnë në komunitetin serb¹²⁴, e deri tek një mekanizëm për ruajtjen e marrëdhënieve të veçanta me Serbinë^{125 126}.

Shumë serbë të Kosovës, pa marrë parasysh dëshirat e tyre sa i përket rolit të asociacionit, janë të vetëdijshëm për realitetin në terren. Ata nuk besojnë në pohimet se asociacioni do të ketë fuqi ekzekutive. Gati 48% e

121 "Është fakt që ata [shqiptarët] e shohin bashkësinë si një Republikë Serbe? Jo, nuk është ashtu, ata e dinë që nuk ka kapacitete...Serbët nuk mund të krijojnë një Republikë Serbe për shkak të mungesës së vazhdimësisë territoriale. Ata duhet të ndalojnë së krijuari frikë në mesin e komunitetit ndërkombëtar dhe në vetvete", intervistë e Grupit për Ballkan, ish kryetar i një komune serbe, 17 qershor 2016.

122 "Shteti i Serbisë është çështje emocionale për serbët e Kosovës. Kush u ka ofruar atyre një zëvendësim [për Serbinë]? Ahtisaari në Prapavijë dhe Beogradi e ka sjellur këtë duke trumpetuar." Intervistë e Grupit për Ballkan, ish kryetar i komunës serbe, 17 qershor 2016. Fokus grupi në Graçanicë, 22 qershor 2016. "Pa prezencën e Serbisë në këtë territor, nuk ka jetë për neve."

123 Fokus grupi në Zubin Potok, 19 maj 2016.

124 Po aty.

125 Fokus grupi në Leposaviq, 8 qershor 2016.

126 Qëllime tjera të përmendura lidhur me asociacionin përfshijnë faktin se do të jetë një trupë që do të administrojë buxhetin e vetë për të parandaluar shantazhet nga lidhshipi shqiptar (Intervistë e Grupit për Ballkan, përfaqësues serb në institucione të Kosovës, 22 maj 2016) në një strukturë orientuese për institucionalizimin dhe zbatimin e politikave praktike të komunave. (Fokus grupi në Mitrovicë, 18 maj 2016; Fokus grupi në Leposaviq, 8 qershor 2016).

atyre që i janë përgjigjur kësaj pyetjeje në komunat veriore ishin pesimistë, dhe vetëm një e treta besojnë se asociacionit do t'i jepen fuqi ekzekutive¹²⁷. Gati një çerek i tyre në Mitrovicë të Veriut dhe në Leposaviq nuk dinë se si të përgjigjen në këtë pyetje¹²⁸, që mund të jetë indikator i pasigurisë së përgjithshme të serbëve në veri. Serbët nga Kosova qendrore ishin edhe më pesimistë: gati dy të tretat ishin të bindur se asociacioni nuk do të ketë kompetenca ekzekutive¹²⁹. Por, çoftë nëse flasin me optimizëm mesatar apo me disfatizëm të plotë¹³⁰, të gjithë e shohin se ky proces do të çojë drejt një tërheqjeje të pakthyeshme të Serbisë nga Kosova.

Serbët janë të vetëdijshëm edhe për pengesat ligjore përveç atyre politike¹³¹. Pritjet janë edhe më të zymta pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese rreth marrëveshjes për asociacionin. Nga perspektiva e serbëve, vendimi i ka vendosur një dry asaj që ishte paraparë, me rreth 40% e serbëve në veri, që besojnë se kjo do të ketë si rezultat më pak fuqi për asociacionin, 35% mendojnë që vendimi i Gjykatës do të shtyjë krijimin e asociacionit ndërsa gati 25% janë të bindur që si rezultat i kësaj, asociacioni nuk do të krijohet fare¹³².

Kryesisht, serbët theksojnë se asociacioni duhet të ketë fuqi ekzekutive, megjithatë është e pakuptueshme se çka ata nënkuptojnë me këtë hë për hë. Shumica hasin në vështirësi në artikulimin e asaj se çka saktësisht nënkuptohet me "fuqi ekzekutive" dhe çfarë efekti mund të kenë ato në praktikë. Siç është pranuar edhe nga vetë serbët, "asnjëri nga ne nuk ka ide se si do të mund të dukej kjo"¹³³. Mungesa e një ideje të qartë se çka do të përmbante kjo është evidente përgjatë gjithë anketimit; shumica e respondentëve kanë aluduar në njëfarë niveli të pavarësisë në vendimmarrje nga Prishtina dhe shkallë të ndryshme të përkrahjes nga bashkëpunimi me Beogradin¹³⁴, por ata shumë rrallë mund të ofronin ndonjë qartësim më të precizuar.

Në kontekst të një pesimizmi të përgjithshëm dhe paqartësisë, prioriteti kryesor për serbët e Kosovës është që asociacioni të ndihmojë ata në përballjen me problemet e përditshme të tyre. Qoftë nëse merret me arsimin, shëndetësinë apo planifikimin urban, serbët thjesht duan që vetë të jenë në gjendje të menaxhojnë disa aspekte të jetës së tyre¹³⁵. Në shumicën e rasteve, ata nuk e shohin asociacionin si mënyrë për të shtrirë ndikimin e Serbisë në Kosovë¹³⁶. Kjo është në kundërshtim të plotë me pikëpamjet e shumicës shqiptare, që janë të preokupuar me çështje të sovranitetit dhe integritetit territorial. Serbët dhe shqiptarët, jo vetëm që flasin gjuhë të ndryshme, ata konceptualizojnë qëllimin e asociacionit në mënyra plotësisht të ndryshme. Ndarja në dy pjesë, në mikro (problemet e

Është koha që
Prishtina të na ofrojë
neve diçka...nuk
brenqosemi se çka,
çfarë sistemi
(përfaqësues lokal,
Mitrovicë e Veriut)

"Kosova nuk është
bërë që serbët të
jetojnë në të"

127 Anketë e Grupit për Ballkan, Qershor 2016.

128 Po aty.

129 Po aty.

130 Fokus grupi në Zveçan, 19 maj 2016. "Bashkësia është vetëm një shaka. Nuk do të ketë perspektivë apo progres sa i përket bashkësisë".

131 "Bashkësia nuk do të ketë gati asnjë kompetencë sipas Kushtetutës së Kosovës." Fokus grupi në Mitrovicë, 18 maj 2016.

132 Anketë e Grupit për Ballkan, qershor 2016

133 Fokus grupi në Graçanicë, 22 qershor 2016.

134 Anketë e Grupit për Ballkan, qershor 2016.

135 "...që mundohemi të marrim vendime për çështje të përditshme." "Ne kurrë nuk do t'ia japim arsimin dhe shëndetësinë shqiptarëve", fokus grupi në Mitrovicë, 18 maj 2016.

136 "Shqiptarët e shohin bashkësinë si një krijim i një Republike Serbe në Kosovë, përderisa shqiptarët janë më të preokupuar me probleme të përditshmërisë se sa me bashkësinë", fokus grupi në Zveçan, 19 maj 2016.

Më parë ishte për serbët që jetonin me Serbinë...Tani ne jemi të brengosur për nevojat tona ekzistenciale, punën, arsimin...A ka ndonjë ofertë Prishtina?

(përfaqësues lokal, Zubin Potok)

“Asociacioni është shpresa ose mundësia e fundit se gjërat do të përmirësohen”

përditshme lokale) dhe makro (shteti dhe territori) po e pengojnë arritjen e një mirëkuptimi të dyanshëm dhe gjetjen e zgjidhjeve për të adresuar shqetësimet e të dy komuniteteve.

Përveç dyshimit se asociacioni nuk do të jetë diçka më shumë se sa një “shoqatë gjuetarësh”,¹³⁷ shumë serbë shohin kufizime në vlerën e shtuar të asociacionit. Po të kishte zbatim dhe respekt të Planit të Ahtisaarit dhe të ligjeve të Kosovës, asociacioni nuk do të ishte fare i nevojshëm.¹³⁸ Megjithatë, serbët mendojnë se të drejtat e tyre nuk po respektohen mjaftueshëm dhe se ligjet e aplikueshme nuk po respektohen¹³⁹, prandaj nuk e shohin as asociacionin si diçka që më në fund do të siguronte për ta, atë që u është premtuar në letër.

Qëndrimet e Serbisë ndaj asociacionit kanë qenë shpeshherë kundërshtuese; edhe nëse ata nuk e dinë se çka do të jetë saktësisht ky asociacion, nëse pala “tjetër” nuk e do atë, atëherë bëhet më i dëshirueshëm. Është një manifestim i qartë i natyrës së “shumës zero” në marrëdhëniet midis dy komuniteteve më të mëdha në Kosovë, dhe një indikator se edhe 17 vjet pas konfliktit, për pajtimin nevojitet rrugë e gjatë. Sipas fjalëve të një konsulenti serb, “paradoksalisht, bashkësia ka fituar peshë politike [për serbët] atëherë kur shqiptarët ngritën tensionet përmes propagandimit të frikës së tyre”¹⁴⁰. Megjithë skepticizmin e tyre, pas dëgjimit të deklaratave nga politikanët në Prishtinë, asociacioni është bërë më tërheqës: “kur e shohim që shqiptarët nuk e duan, atëherë duhet të jetë diçka e mirë, dhe ne e duam edhe më shumë”¹⁴¹.

Pa një asociacion i cili do t’ju jepte serbëve më shumë liri në vendim-marrje rreth menaxhimit të çështjeve të tyre, ky institucion do të ishte i tepërt e edhe i dëmshëm. Sipas fjalëve të një pjesëmarrësi në fokus grupin në Graçanicë, është “një institucion i padobishëm që do të rëndojë jetën dhe do të devijojë buxhetin e komunës dikah tjetër...në aspektin afatgjatë mund të jetë një mekanizëm për ‘ngritje të kokave’, por që gjithashtu mund të jetë plotësisht kundër-produktiv.”¹⁴² Përgjatë komunave të ndryshme, serbët vënë në pikëpyetje arsyen e ekzistencës së tij, nëse asociacioni do t’ju sjellë diçka më shumë se ajo që tashmë e kanë. Mendimet rreth kësaj janë pothuajse unanime: “Nëse bashkësia e komunave serbe do të jetë një asociacion, është krejtësisht i parëndësishëm,”¹⁴³ “Bashkësia nuk ka asnjë vlerë”¹⁴⁴ dhe “pa fuqi nuk ka asnjë kuptim që të ekzistojë.”¹⁴⁵ Në skajin më pesimist të spektrit, Marrëveshja e Brukselit duket se “ka marrë atë që ata kishin tashmë” duke dobësuar lidhjet me Serbinë dhe duke vënë në pikëpyetje mbijetesën e institucioneve që ruajnë ekzistencën e komunitetit serb në Kosovë.¹⁴⁶

Të jetuarit në një limbo në mes të lojtarëve të fuqishëm dhe burimeve të

137 Intervistë e Grupit për Ballkan, përfaqësues serbë nga veriu i Kosovës, 25 maj 2016.

138 Fokus grupi në Graçanicë, 22 qershor 2016. “Të drejtat e parapara nga Plani i Ahtisaarit, të njëjtat të drejta të cilat janë reduktuar dhe futur në Kushtetutë nuk janë duke u zbatuar.”

139 Kjo çështje është analizuar më në detaje në nën-kapitullin e mëposhtëm.

140 Po aty.

141 Intervistë e Grupit për Ballkan, përfaqësues serb në institucione të Kosovës, 22 maj 2016.

142 Fokus grupi në Graçanicë, 22 qershor 2016.

143 Fokus grupi në Zubin Potok, 19 maj 2016.

144 Fokus grupi në Zveçan, 19 maj 2016.

145 Fokus grupi në Mitrovicë, 18 maj 2016.

146 Fokus grupi në Mitrovicë, 18 maj 2016.

ndryshme të presionit, ka bërë që serbët e Kosovës të kuptojnë se pozita nga e tyre negociuese është e limituar. Pranimi se “është më se e nevojshme që serbët të japin diçka për të përfituar diçka tjetër”¹⁴⁷ do të ndihmonte në krijimin e bazës për fillimin e bisedave në mes të Prishtinës dhe serbëve të Kosovës. Nëse bashkëqytetarët shqiptarë, e kuptojnë që “problemi kryesor është mungesa e besimit nga të dy palët”¹⁴⁸, ky do të ishte një hap i rëndësishëm drejt zgjidhjes së problemit me asociacionin.

Megjithatë, krijimi i kushteve për kompromis do të jetë një punë e vështirë; qoftë përmes mbajtjes së zgjedhjeve në kuadër të infrastrukturës ligjore të Kosovës¹⁴⁹, shpërbërjes së mbrojtjes civile dhe institucioneve të drejtësisë dhe integritit të policisë në Policinë e Kosovës¹⁵⁰, ndjenja kryesore është që serbët nuk kanë se çfarë kompromisesh tjera të bëjnë¹⁵¹. Tani topi është në anën e Prishtinës përmes asociacionit, e që është “i vetmi koncesion që Prishtina ka bërë, edhe ai është duke u kushtëzuar në implementim”¹⁵².

ASOCIACIONI SI MJET PËR TË RUAJTUR NJË MËNYRË JETESE

Për serbët, ndërkohë që ata integrohen plotësisht në shtetin e Kosovës, asociacioni është ndoshta mjeti i fundit i mbetur për t’ju siguruar që ata të vazhdojnë me mënyrën e tyre të jetesës si komunitet në vete. Procesi i Brukselit ka pasur një ndikim të madh në mënyrën se si serbët e shohin perspektivën e tyre për një të ardhme të sigurtë dhe të begatë në Kosovë. Shumë theksojnë keqmbërjet e mëparshme dhe të tanishme kundër serbëve, mungesën e dënimit publik të tyre nga liderët politikë të shumicës shqiptare¹⁵³, dhe një mungesë totale të hetimit dhe dënimit të tyre, si një provë se nuk ka vullnet të mirë nga ana e shumicës shqiptare për të mirëpritur serbët në Kosovë¹⁵⁴. Ndërkohë që kthimi i serbëve pas luftës ishte një mundësi për të rindërtuar besimin mes dy komuniteteve¹⁵⁵, por ai ka dështuar^{156 157}. Integrimi nga perspektiva e serbëve varet jo

“Ka frikë se vullneti i shumicës do të vendoset me forcë... dhe asociacioni i komunave serbe shihet si një mekanizëm potencial që do e mbrojë komunitetin kundrejt kësaj”

“Ne nuk po shikojmë në atë se a do të lëvizim në një sistem tjetër, por nëse do mund të mbijetojmë”

Prishtina na shkakton shumë pengesa në rrugën tonë...Beogradi na dëmton politikisht. Marko Gjuriq nuk na lejon të flasim çka duam...Ai ka bllokuar komunikimin tonë me institucionet e Beogradit dhe ai nuk na lë të merremi me Prishtinën.
(zyrtar i Listës Serbe)

147 Fokus grupi në Zveçan, 19 maj 2016.

148 Fokus grupi në Zubin Potok, 19 maj 2016.

149 Intervistë e Grupit për Ballkan me përfaqësues serbë në institucionet e Kosovës. “Ata kanë bërë një kompromis – ata shkuan në zgjedhje në veri. Ky është kompromisi më i madh i mundshëm. Prishtina vetëm mund të ëndërrojë për organizim të zgjedhjeve në veri sipas ligjeve të Kosovës. Kjo nuk do të mund të ndodhte pa Beogradin. Kështu, me kuti dhe koka të thyera, por zgjedhjet u mbajtën, komunat u formuan – ky është një kompromis. Fakti që Beogradi nuk ka mundur ta valorizojë këtë kompromis është histori tjetër.”

150 Fokus grupi në Leposaviq, 8 qershor 2016.

151 Intervistë e Grupit për Ballkan me përfaqësues serbë në institucionet e Kosovës.; Fokus grupi në Leposaviq, 8 qershor 2016.

152 Fokus grupi në Leposaviq, 8 qershor 2016; Intervistë e Grupit për Ballkan, përfaqësues serb i Kosovës. “Nuk ka kompromise tjera që mund të bëhen nga komuniteti serb, sepse ata tashmë kanë bërë të gjitha kompromiset. Ne jemi mjaft bashkëpunues...Qytetarët serbë presin lëvizje positive nga Prishtina. Ne nuk mund të shkojmë më larg se kaq. Ajo që pritet është bashkësia e komunave serbe dhe atë të zgjidhet sa më shpejt, ngase jo vetëm qytetarët shqiptarë do të jenë në pozitë shumë më të mirë, por edhe serbët dhe komuniteti ndërkombëtar. Shumë gjëra do të fillonin të ecin në drejtim pozitiv nëse bashkësia formohet...”

153 “Pyetja është nëse shqiptarët kanë dënuar publikisht ndonjë nga këto sulme, kjo pyetje duhet t’ju bëhet të gjitha partive politike në Kosovë.” Fokus grup, Zveçan, 19 maj 2016

154 “Pjesa më e keqe për situatën e tanishme është që asnjëra nga këto incidente nuk është proceduar apo dënuar në mënyrë adekuate.” Fokus grup, Zveçan, 19 maj 2016

155 Fokus grup, Graçanicë, 22 qershor 2016.

156 Fokus grup, Leposaviq, 8 qershor 2016. “është shumë vonë tani...kthimi ishte një mundësi, por dështoi, marsi 2004 ishte një mesazh i tmerrshëm.”

157 Duke shprehur një opinion të përhapur gjerësisht, pjesëmarrësit në fokus grupet në Zveçan dhe Leposaviq thanë, “fillimisht, shqiptarët nuk duhet të hapin zjarr dhe të gjuajnë bomba ndaj atyre që kthehen,” “ata duhet të tregojnë që ata vërtetë duan që serbët të rrinë në këtë territor, por ata nuk po e tregojnë këtë.” Fokus grup, Zveçan, 19 maj 2016. “ata duhet të tregojnë që ata vërtetë duan që serbët të rrijnë në këtë territor, por ata nuk po e tregojnë këtë.” Fokus grup, Leposaviq, 8 qershor 2016.

nga privilegjet e mëtejme¹⁵⁸, por nga përmirësimi i marrëdhënieve mes komuniteteve dhe trajtimi i drejtë i serbëve nga shumica; "Kosova duhet të ndalojë dhunën ndaj serbëve, nëse nuk e bën këtë nuk ka integrim dhe nuk ka diskutim për të. Shqiptarët duhet t'i reduktojnë në minimum pozicionet e tyre ekstreme"¹⁵⁹.

Lista e padrejtësive të cialt serbët ndjejnë është e gjatë. Rastet e pazgjydhura të pronave të uzurpuara¹⁶⁰, dëmtimi i trashëgimisë kulturore serbe¹⁶¹, mospërfillja e ligjit për përdorimin e gjuhëve¹⁶², ndjenjat e mungesës së sigurisë dhe lirisë së lëvizjes¹⁶³ i çojnë serbët në përfundimin se "Kosova nuk është bërë për serbët dhe serbët nuk ndihen mirë këtu"¹⁶⁴. Bashkë me faktin se duhet të përballen me shumë pengesa praktike dhe administrative, si vështirësitë në marrjen e letërnjoftimit kosovar dhe refuzimi i institucioneve të Kosovës për të njohur martesat serbe të bëra pas 1999¹⁶⁵, për serbët nuk ka ndonjë indikacion se situata do të ndryshojë në të ardhmen e afërt¹⁶⁶. Ndërkohë që Graçanica dhe komunat tjera serbe në Kosovën jugore prezantohen nga institucionet e Kosovës dhe shoqëria civile si sukses i integritit, serbët nga veriu i shohin ato si një tjetër faktor dekurajues për pranimin e juridiksionit të Prishtinës¹⁶⁷. Deklarata të tilla si kjo që jehuan në fokus grupin e Graçanicës i prekin ata në shumicën e rasteve: "çdo ditë ka presione dhe shqetësime"¹⁶⁸. Serbët në Kosovën qendrore e kanë bërë të qartë se niveli i tyre i komunikimit me Prishtinën ishte i sforcuar, një marrëdhënie që ata e pranojnë nga nevoja, por jo më shumë se kaq.

Megjithatë, serbët janë të vetëdijshëm për nevojën e koekzistencës dhe japin sinjale se përpjekjet e komunitetit shqiptar për t'u lidhur me ta do mirëpritëshin. Një pjesëmarrës në fokus grupin e Zveçanit paralajmëroi se ka një nevojë për "të pranuar realitetin që çështja e mbijetesës së serbëve të Kosovës nuk varet nga Beogradi, por nga Prishtina. Sjellja e shqiptarëve ndaj serbëve do të ketë ndikim më të madh"¹⁶⁹. Rindërtimi i besimit dhe pajtimi mes dy komuniteteve janë kushtet paraprake themelore për paqen brenda komuniteteve¹⁷⁰, një proces në të cilën asociacioni mund të jetë i dobishëm¹⁷¹. Në vend që të përforcojë ndarjet etnike të theksuara nga kundërshtarët e asociacionit nga ana shqiptare, organi do të ishte një mjet

158 Fokus grup, Leposaviq, 8 qershor 2016. "Ne nuk duam përfitime nga Prishtina, ne nga fshatrat nuk kemi interes për to."

159 Fokus grup, Zubin Potok, 19 maj 2016.

160 Fokus grup, Graçanicë, 22 qershor 2016.

161 Fokus grup, Leposaviq, 8 qershor 2016.

162 "Ligji për përdorimin e gjuhës është thjesht një gjësend, edhe shumë ligje të tjera janë diçka tjetër në letër e diçka tjetër në praktikë." Fokus grup, Graçanicë, 22 qershor 2016.

Fokus grup, Leposaviq, 8 qershor 2016. "Unë pash një kryetar komune serbe të ankohej në televizor se ai i pranon të gjitha dokumentet në gjuhën shqipe dhe se ai nuk është në gjendje t'i përkthejë ato. Ata pranojnë dokumente për buxhetin e komunës në shqip dhe ajo bëhet me qëllim nga administrata qendrore në Prishtinë. Ka prova të qarta që këto nuk janë qëllime të mira. Nëse do të donin ata do kishin krijuar një departament të gjuhës dhe çdo herë t'i bëjnë përkthimet dhe të dërgojnë gjithçka që nevojitet."

163 Fokus grup, Zveçan, 19 maj 2016.

164 Fokus grup, Leposaviq, 8 qershor 2016.

165 Fokus grup, Zubin Potok, 19 maj 2016. "për t'i pranuar dokumentet, institucionet e Kosovës nuk pranojnë as martesë as prejardhje nga Kosova, as lindje në Kosovë."

166 Fokus grup, Graçanicë, 22 qershor 2016.

167 Fokus grup, Leposaviq, 8 qershor 2016. "Integrimi i serbëve shihet më së miri në integrimin e serbëve në jug të Ibrit – ata nuk kanë përvoja të mira dhe pse do pranonim ne diçka që është e keqe."

168 Fokus grup, Graçanicë, 22 qershor 2016.

169 Fokus grup, Zveçan, 19 maj 2016.

170 Fokus grup, Zubin Potok, 19 maj 2016; Fokus grup, Zveçan, 19 maj 2016.

171 Fokus grup, Zveçan, 19 maj 2016. "Bshkësia duhet të kthejë besimin reciprok d.m.th. koekzistencën."

për të tejkaluar dallimet duke zbutur frikën e serbëve ndaj shumicës.

Por, për faktin se e kaluara është shumë negative nga pikëpamja e tyre¹⁷², serbët shqetësohen për fatin e tyre kur qendra e gravitetit politik dhe ligjor lëviz nga Beogradi te Prishtina. Duke mbajtur një nivel të përfshirjes së Beogradit dhe duke siguruar një nivel pavarësie nga institucionet qendrore në Prishtinë, asociacioni do të shërbente si një barrierë mbrojtëse kundër armiqësive potenciale (dhe të pritura) nga institucionet dhe popullata e shumicës¹⁷³. Serbët e Kosovës ndihen të cenuar nga perspektiva e mundshme e tensioneve me shumicën shqiptare që i sheh ata negativisht pa pasur atë pak siguri që Beogradi iu ofron atyre¹⁷⁴.

Rritja e rëndësisë së asociacionit në sigurimin dhe/ose përmirësimin e jetës së serbëve në Kosovë dhe marrëdhëniet e tyre me Prishtinën është shumë e dukshme në rezultatet e anketës. Bashkë me problemet e sigurisë fizike dhe ekonomike dhe respektimin e ligjeve sa i përket të drejtave të komuniteteve, formimi i asociacionit shpesh citohet si një hap që do të sinjalizonte një vullnet të vërtetë të shumicës për të ndarë një shoqëri të përbashkët me serbët. Sipas anketës, ky qëndrim është një tregues i fuqishëm se asociacioni, nëse formohet, do të kishte ndikim në relaksim të përgjithshëm të ndjenjave që serbët mund të kenë drejt shtetit të sapoformuar të Kosovës.

Një tjetër avantazh nga i cili asociacioni shihet nga serbët si një çështje mbijetese është transferimi i disa institucioneve publike jetike nga sistemi i Serbisë në atë të Kosovës. Sidomos në shëndetësi dhe arsim ka paputhshmëri të shumta të cilat drejtpërdrejt ndikojnë në mundësinë e serbëve për të qëndruar në Kosovë. Asociacioni duhet të shërbejë si një mekanizëm për t'i mbajtur këto fusha themelore duke funksionuar ashtu siç kanë funksionuar kur kanë qenë pjesë e Serbisë, sa më shumë që të jetë e mundshme brenda kontekstit të ri ligjor dhe praktik. Përveç shëndetësisë dhe arsimit, serbët kanë theksuar disa fusha në të cilat asociacioni do të kishte kompetenca më të mëdha, duke përfshirë sistemin e pensioneve dhe sigurimit shëndetësor, planifikimin urban, kulturën, bashkëpunimin ndërkomunal dhe rajonal si dhe fondin zhvillimor për veriun. Por, shumica theksojnë se sidomos shëndetësia dhe arsimi përbëjnë një kufi që nuk duhet kaluar e i cili përcakton nëse serbët do të zhvendosen nga Kosova.

Transferimi i institucioneve të shëndetësisë dhe arsimit nga sistemi i Serbisë në atë të Kosovës do të kërkonte një reduktim të theksuar të numrit të mjekëve dhe mësuesve dhe qindra familje do të vuanin nga humbja e të ardhurave të nevojshme për të mbijetuar. Buxheti i shtetit të Kosovës nuk mjafton për financimin e vendeve të punës që më parë janë financuar nga Serbia, dhe marrëveshjet e mundshme për transferimin e mundshëm të fondeve nga Serbia tek asociacioni përmes Prishtinës për këtë qëllim, ngrisin pritje të shumta tek serbët.

Serbët janë veçanërisht të brengosur për vonimin e mundshëm të fondeve të Serbisë (me qëllim ose jo) të institucioneve qendrore të Kosovës. Siç

172 Fokus grup, Zubin Potok, 19 maj 2016. "problemi është që nuk ka pasur ndonjëherë oferta/përprojekte, vetëm kërcënime."

173 Fokus grup, Mitrovica, 18 maj 2016. "Asociacioni është shpresa ose mundësia e fundit se gjërat do të përmirësohen." Fokus grup, Leposaviq, 8 qershor 2016.

174 "gjithmonë flasin për serbët në kontekst negativ" Fokus grup, Graçanicë, 22 qershor 2016.

“Prishtina na shkakton shumë probleme, kryesisht administrative, që dëshmojnë për mungesën e vullnetit për të na integruar. Por, sot, problemi ynë i vërtetë është pengesa që na shkakton Beogradi, veçanërisht zyra për Kosovë dhe Metohi. Ata nuk na lejojnë të flasim për çështjet tona”

argumentohet, asociacioni duhet të jetë në krye të financave në mënyrë që të sigurojë disponueshmëri të fondeve të pandërprera për të mbështetur funksionimin e institucioneve jetike. Meqenëse kjo lidhet me shërbimet themelore si shëndetësia dhe arsimit, asociacioni do të ishte një faktor i rëndësishëm në mbijetesën fizike dhe kulturore të serbëve në Kosovë.

Një seri tjetër shqetësimesh, për shembull, ka të bëjë me qendrën klinike në Mitrovicën veriore që operon si qendër shëndetësore kryesore (spital) për shkak të rëndësisë së saj dhe financimit brenda sistemit serb. Por, sipas legjislacionit të Kosovës, do të ishte institucion i nivelit sekondar, ose madje terciar. Kjo përmban shumë lloje të implikimeve¹⁷⁵ sepse një ulje në nivel të institucionit të shëndetësisë do të thotë që serbët a) do të kishin vështirësi të mëdha të marrin trajtim në Serbi për shërbime që nuk mbulohen në Kosovë si nga sistemi serb ashtu edhe ai i Kosovës; b) do të duhej të paguanin për shumicën e shërbimeve dhe medikamenteve që tashmë paguhen nga sistemi i Serbisë; dhe c) do të duhej të merrnin trajtim në institucione të dobëta sa i përket cilësisë në Kosovë. Pavarësisht nga mungesat dhe sfidat që ballafaqohen institucionet shëndetësore të Serbisë, ka një besim të përhapur që ato janë superiore krahasuar me ato të ofruara nga sistemi i Kosovës. Mungesa e një sistemi të përgjithshëm të sigurimit shëndetësor dhe cilësia e ulët e kujdesit shëndetësor në Kosovë janë shqetësimet kryesore. Serbët mendojnë se as shqiptarët nuk i besojnë sistemit të vet shëndetësor, dhe që shpesh kërkojnë ndihmë mjekësore në institucionet e Serbisë dhe përdorin identitet dhe dokumente shëndetësore serbe.¹⁷⁶ Kjo i bën serbët dyshues për të përqafuar potencialisht sistemin e Kosovës në të ardhmen. Lidhur me nënshtrimin ndaj shqyrtimit të hollësishëm të të gjitha fushave tjera të dispozitave të shërbimeve shtetërore dhe performancës ekonomike, serbët përfunduan se “Kosova nuk ka bërë mjaftueshëm për shqiptarët, e lëre më për serbët”¹⁷⁷ dhe që “Shqiptarët jetojnë më keq se para 1999 dhe para se të bëheshin shtet.”¹⁷⁸ Besimi se ka pak, ose aspak, që sistemi i Kosovës mund t’ju ofrojë serbëve¹⁷⁹ shpjegon rezistencën e tyre për të lëvizur nga çka ata shohin si një sistem të mirë tek një sistem më i dobët.¹⁸⁰

Asociacioni si i tillë shihet si një mekanizëm që do të shmangte ato pasoja të padëshirueshme për serbët, por serbët nuk kanë marrë sigurime të mjaftueshme që sistemi do të mbetet i tillë. Mesazhi nga Kosova dhe komuniteti ndërkombëtar gjithmonë ka qenë se numri i punëtorëve do të reduktohet në mënyrë të konsiderueshme. Në anën tjetër, Aleksandar Vulin (Ministri serb i Punës, Punësimit, Veteranëve dhe Politikave Sociale), ka thënë shpesh se “ne nuk do të humbim asnjë vend punë”.¹⁸¹ Mesazhe të ndryshme nga burime të ndryshme mund dhe do të krijojnë huti te banorët, duke ngritur frikën e tyre dhe ndjenjën e pasigurisë sa i përket nevojave të tyre bazike për mbijetesë.

175 Intervistë e Grupit për Ballkan, përfaqësues i institucioneve serbe në Kosovë, 22 maj 2016. “Spitali momentalisht punëson 3000 persona. Pas reduktimit në numër, çka supozohet të bëjmë ne me 2500 persona të papunë?...Numrat janë të njëjtë për të gjitha institucionet – ne po flasim për mijëra pozita pune këtu.”

176 “As vetë shqiptarët nuk i besojnë sistemit të tyre shëndetësor.” Fokus grup, Leposaviq, 8 qershor 2016; Fokus grup Mitrovica, 18 maj 2016

177 Fokus grup, Leposaviq, 8 qershor 2016.

178 Fokus grup, Zubin Potok, 19 maj 2016.

179 Po aty.

180 Intervistë e Grupit për Ballkan, zyrtar i komunës së Zubin Potok, 17 maj 2016.

181 <http://www.blic.rs/vesti/politika/vulin-srbija-ce-nastaviti-da-pomaze-srbe-na-kosovu/82ylqvf>

Niveli i zhvillimit të kulturës politike në Kosovë është një tjetër brengë për serbët, sidomos për ata që, vështrojnë nga larg, janë të mbrojtur nga ndikimi i plotë i realitetit politik të Kosovës përmes lumit Ibër dhe përmes prezencës së shtetit serb. Degradimi potencial i vlerave demokratike që serbët i kanë për zemër si rezultat i integritetit shkakton parehati.¹⁸² Kjo është kështu, pa marrë parasysh faktin që elita serbe në Kosovë, në vend të votës së popullit, erdhi në pushtet përmes mashtrimit zgjedhor dhe caktimeve direkte nga Beogradi.¹⁸³ Frustrimi me këtë është prezent tek serbët në veri dhe në jug, prirjet demokratike të cilëve janë shkelur, por mungesa e kulturës demokratike të Kosovës mbetet si më e keqja nga të dy alternativat.

Në një skenar ku ndryshime drastike do të bëheshin në sistemet e shëndetësisë dhe arsimit, nëse asociacioni nuk përdoret si një mjet 'bisedimesh', për shumë prej tyre mërgimi do të mbetet i vetmi opsion.¹⁸⁴ Të qëndrosh në Kosovë ka qenë zgjedhja inferiore për vite, me "një frikë reale që njerëzit kanë sakrifikuar të ardhmen e fëmijëve të tyre për faktin e thjeshtë se kanë vendosur të qëndrojnë këtu."¹⁸⁵ Asociacioni do të shërbente gjithashtu si një ndërmjetësues politik mes serbëve dhe Prishtinës, duke lejuar serbët të ruajnë pjesërisht kulturën e tyre. Nëse nuk ndalohet mërgimi i serbëve, të paktën mund të ngadalësohet. Mesazhi është i qartë: "Ne nuk po shikojmë në atë se a do të lëvizim në një sistem tjetër, por nëse do mund të mbijetojmë."¹⁸⁶

HALLKA QË MUNGON: DUKE KËRKUAR NJË UDHËHEQËSI SERBE AUTENTIKE

Ka një besim të përhapur mes serbëve të Kosovës se varet nga ajo se kush e udhëheq atë se a do të ketë asociacioni ndikim pozitiv në jetën e tyre. Nëse liderët e tanishëm serbë të Kosovës do e udhëhiqnin këtë organ, besimi i përgjithshëm është që do bëhej një instrument tjetër nominal i cili nuk do të prodhonte rezultate të prekshme. Mbi të gjitha, liderët serbë të Kosovës janë të njohur nga zgjedhjet lokale të manipuluar në vitin 2013, të orkestruara nga Beogradi. Një pjesëmarrës i një fokus grupi theksoi, "përmes zgjedhjeve joligjore dhe jo legjitime ne fituam përfaqësuesë jo legjitime,"^{187 188} pa ndonjë ndikim real në komunitet¹⁸⁹ dhe vetëm servilë ndaj Beogradit.^{190 191} Intervenime të tilla në shprehjen demokratike të qytetarëve

182 Intervistë e Grupit për Ballkan, zyrtar i komunës së Zubin Potok, 17 maj 2016. "Elita shqiptare e Kosovës funksionon në mënyrë jofunksionale. Nuk ka decentralizim në Kosovë dhe çdo gjë është e lidhur me Ministrinë e Financave dhe agjendën e qeverisë së gjerë. Prandaj, çdo gjë është nën kontrollin e vullnetit të institucioneve qendrore. Sistemi është i CENTRALIZUAR."

183 Fokus grup, Leposaviq, 8 qershor 2016.

184 "Nëse nuk ke mundësi ta dërgosh fëmijën tënd të arsimohet ose nuk mund të shkosh te doktori, ju duhet të largoheni nga ai vend. Në rastin kur këto dy sisteme dështojnë, unë pres një migrim tejet të madh." Intervistë e Grupit për Ballkan, përfaqësues i institucioneve serbe në Kosovë, 22 maj 2016.

185 Fokus grup, Graçanicë, 22 qershor 2016.

186 Fokus grup, Zveçan, 19 maj 2016.

187 Fokus grup, Leposaviq, 8 qershor 2016. "Duhet dihet se përfaqësuesit tanë nuk janë përfaqësuesit tanë, por janë caktuar përmes forcës dhe zgjedhjeve të manipuluar."

188 Fokus grup, Leposaviq, 8 qershor 2016.

189 Fokus grup, Leposaviq, 8 qershor 2016; Fokus grup, Zveçan, 19 maj 2016: "Politikanët nga veriu i Kosovës nuk e kanë mbështetur e popullit, shumica vijnë në Prishtinë për të marrë rrogën. Së fundi, situata ka ndryshuar pak me Slavko Simiq i cili të paktën thotë diçka për problemet e tanishme. Në zgjedhjet e ardhshme parlamentare në Kosovë pyetja do jetë nëse njerëzit që ishin dikur aktiv në politikë do riaktivizohen."

190 Fokus grup, Graçanicë, 22 qershor 2016; Fokus grup, Mitrovica, 18 maj 2016. "Problemi është që ka njerëz që vijnë nga Beogradi dhe vendosin."

191 Intervistë e Grupit për Ballkan, ish-kryetar i një komune serbe, 17 qershor 2016. "Serbët kurrë nuk ndërtuan ekzistencën e tyre politike. Truri është lënë në një kavanoz në Merdare dhe udhëzimet kërkohen nga Beogradi."

prodhuan një mosbesim të vërtetë mes liderëve serbë (lista serbe e drejtuar nga Beogradi) në Kosovë dhe komunitetit serb. Në mesin e komunitetit serb të Kosovës, kanë lindur dyshime për qëllimet e vërteta të Serbisë prapa gjithë procesit të dialogut.¹⁹² Përshtypja se Kosova, dhe me këtë rast edhe serbët e Kosovës, janë bërë mjet negociimi i Beogradit për anëtarësim në BE¹⁹³, i jep shtytje kërkesave lokale për një udhëheqësi autentike e zonja për vendim-marrje të pavarur. Komuniteti vajton mundësitë e humbura në të kaluarën për të ndërtuar një udhëheqësi e cila do të përfaqësonte interesat e vërteta të serbëve të Kosovës.¹⁹⁴ Duke ilustruar frustrimin e tyre, një pjesëmarrës i një fokus grupi thotë “Deputetët serbë (të Kosovës) përballen me më shumë pengesa prej zyrës për Kosovë dhe Metohi [në Qeverinë e Serbisë] se sa nga shqiptarët.”¹⁹⁵

Përveç çështjeve të legjitimitetit, Lista Serbe po vuan më së shumti nga ndasitë brenda radhëve të saj.¹⁹⁶ Përderisa mungesa e unitetit dhe si rrjedhojë mungesa e fuqisë politike mund të ketë penguar përfshirjen më të madhe të përfaqësuesve të Listës Serbe gjatë krizës politike në Kosovë, mund të ketë parandaluar eskalimin e mëturshëm në mes të serbëve dhe shqiptarë rreth çështjes së asociacionit,¹⁹⁷ kjo edhe mund të jetë një paralajmërim që zbatimi eventual mund të dëmtohet nga ndasitë brenda vetë serbëve. Nga perspektiva e serbëve të zakonshëm, kjo mund të përkthehet lehtë në një dështim tjetër për t’i përfaqësuar interesat e tyre në mënyrë adekuate.

Sfidat e lartpërmendura komplikohen edhe më tej nga mungesa e kapaciteteve për të zbatuar detyrat dhe përgjegjësitë e një asociacioni. Komuniteti serb e pranon se as lidhshipi aktual e as alternativat e mundshme (liderët e kaluar, liderët e mundshëm më të rinj) nuk kanë aftësitë e nevojshme për të udhëhequr trupën që do të krijohet.¹⁹⁸ Çështja e kapaciteteve aktuale shkon përtej aftësive thjesht burokratike; ka dyshime nëse ka mjaftueshëm serbë që flasin gjuhën angleze, që dinë gjithëçka rreth zbatimit të projekteve, që mund të punojnë në kuadër të kornizës ligjore të Kosovës dhe/apo që dinë të përdorin kompjuterët. Problemi është thellë i rrenjosur dhe i shpërndarë gjerësisht. Dështimi për të zhvilluar kapacitete politike është mangësi e qasjes afatgjate të Serbisë ndaj Kosovës: “Problemi është se politika asnjëherë nuk ka lejuar krijimin e kapaciteteve të besueshme njerëzore që të bëjnë politika dhe që ta udhëheqin shoqërinë në përgjithësi. Lëvizja për Rimëkëmbjen e Serbisë (Serbisht: Srpski pokret obnove) ka qenë lëvizja e parë autoktone politike e serbëve të Kosovës dhe Beogradi nuk ka lejuar krijimin e një platforme autentike politike. Beogradi ka hequr dorë se do të udhëheqë më, por serbët e mbetur në Kosovë janë të paaftë dhe nuk do të kenë edhe ashtu

Ata po dëmtojnë veten e poashtu edhe Beogradin...Njerëzit nuk e dinë se prej nga vijnë direktivat, satelitët e Beogradit janë faktori kryesor për situatën në Kosovë.”

192 Intervistë e Grupit për Ballkan, ish-kryetar i një komune serbe, 17 qershor 2016. “Nga i pari e deri te i fundit serbët i besojnë Beogradit dhe i dëgjojnë ata edhe pse e dinë që po bëjnë gabim. Ata e shohin që mesazhi që e kanë marrë nga përfaqësuesit e Beogradit në Kosovë është duke u interpretuar gabimisht tek ata.”

193 Fokus grup, Mitrovicë, 18 maj 2016. Intervistë e Grupit për Ballkan, përfaqësues i institucioneve serbe në Kosovë, 22 maj 2016. “Unë mendoj se serbët e Kosovës nuk ishin asnjëherë me rëndësi për Beogradin.”

194 Fokus grup, Graçanicë, 22 qershor 2016.

195 Fokus grup, Zveçan, 19 maj 2016; Intervistë e Grupit për Ballkan, përfaqësues serb i institucioneve në Kosovë, “...Serbët janë të çorientuar me mungesën e perspektivave të tyre, ata humbën një elitë politike, Beogradi pyetet për çdo gjë, të gjithë janë të frikësuar nga mosmiratimi i Beogradit sepse ajo mund të jetë e rezikshme, dhe me pasoja.”

196 Intervistë e Grupit për Ballkan, anëtar i Listës Serbe, 11 qershor 2016.

197 Intervistë e Grupit për Ballkan. Zyrtar komunal në Zubin Potok, 17 maj 2016.

198 Fokus grupi në Graçanicë 22 qershor 2016.

marrëdhënie me shqiptarët.”¹⁹⁹

Shumica janë të mendimit se serbëve të Kosovës duhet t’ju mundësohet komunikimi direkt me Prishtinën, pa ndërhyrjen e Beogradit. “Ne e mbështesim atë që po thotë Lëvizja Vetëvendosje se me serbët nga Kosova duhet të flitet drejtpërdrejt, e jo përmes Beogradit.”²⁰⁰ Koha se kur Beogradi do të vendos ‘t’i lajë duart’ nga serbët e Kosovës dhe sa hapësirë do t’ju jepet atyre për të konsoliduar kapacitetet e tyre politike dhe ekzekutive do të ketë një ndikim të drejtpërdrejt në rolin që asociacioni do të luaj në jetën e komunitetit serb dhe të shtetit të Kosovës.²⁰¹ Siç është thënë shkurt nga një konsulent serb në Kosovë, “Serbia duhet t’ju ndihmojë serbëve të Kosovës, jo t’i udhëheqë ata”.²⁰²

199 Fokus grupi në Graçanicë 22 qershor 2016

200 Fokus grupi në Leposaviq, 8 qershor 2016.

201 Intervistë e Grupit për Ballkan, ish kryetar i komunës serbe, Graçanicë, 17 qershor 2016. “Është shumë e rëndësishme se kush do ta udhëheq atë, kush do t’i përfaqësojë interesat e serbëve. Ka të bëjë me autoritete personale, politike, morale dhe kapacitete të tjera. Kjo është një nga çelësat. Emri nuk është i rëndësishëm, e rëndësishme është se çka do të përfaqësojë. Forma nuk është e rëndësishme.”

202 Intervistë e Grupit për Ballkan, zyrtar serb në Qeverinë e Kosovës, 20 maj 2016.

PËRFUNDIME





Themelet dhe e tërë rrjedha e procesit të dialogut në mes të Beogradit dhe Prishtinës janë përcjellë me shumë defekte. Procesi ka rrezik të ndërpritet. BE-ja ka qenë neglizhente në përcaktimin e tonit, shtyrjen përpara të çështjeve për diskutim dhe në avancimin e dialogut. Qeveritë e Kosovës dhe të Serbisë kanë dështuar që të respektojnë dhe zbatojnë marrëveshjet. Vazhdimi i dialogut, që kësaj radhe është ri-strukturuar që të fokusohet në normalizimin e marrëdhënieve bilaterale në mes të qeverive të Kosovës dhe të Serbisë, është çelësi për avancimin e normalizimit, pajtimit, përmirësimin të marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe në sigurimin e një jete të mirë për serbët e Kosovës. Krahas ristrukturimit të dialogut dhe vendosjes së një fryme të re, puna në themelimin e asociacionit të komunave serbe duhet të vazhdojë. Për këtë, në Bruksel është arritur pajtimi si nga Kosova ashtu edhe nga Serbia. Një udhërrëfyes transparent dhe i qartë duhet të prezantohet për zbatimin e asociacionit, e kësaj radhe shumica e punës duhet të ndodhë përbrenda Kosovës.





Qeveria e Kosovës dhe opozita duhet të ulen bashkë dhe të zhvillojnë udhëzime të reja për dialogun me Serbinë. Ato duhet të zotohen për zbatimin e asociacionit në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe duhet të zhvillojnë një udhërrëfyes për zbatimin e progresit të integritetit të komunitetit serb të veriut. Serbët nga të gjitha sektorët duhet të ftohen për konsultime dhe dialog për të promovuar vlerat dhe dobitë e integritetit që shkojnë përtej asociacionit të komunave. Serbët duhet të inkurajohen që të marrin pjesë në të gjitha politikat publike dhe shtetërore.



Asociacioni nuk duhet të jetë një instrument për Beogradin. Është vetëm për përfitimin e serbëve të Kosovës. BE-ja ka lejuar që Beogradi të fitojë avantazh në Kosovë, me kontrollim të gjerë të serbëve. Drejtimi i njëanshëm i dialogut është pranuar edhe nga diplomatë të lartë dhe me ndikim nga vendet anëtare të BE-së dhe kjo duhet të përmirësohet menjëherë. Kontrolli i Beogradit mbi serbët vendorë është bërë i padurueshëm për ata që ndihen të paafte për ta kundërshtuar. Ata duan që komuniteti ndërkombëtar t'i lirojë ata nga ky kontroll në mënyrë që të kenë autoritetin që vetë të vendosin për të ardhmen e tyre. Politika e Beogradit për serbët e Kosovës rritë edhe më shumë frikën në mesin e shqiptarëve. Transparenca, debatet e mirëfillta publike dhe përfshirja e personave, jeta e të cilëve ndikohet drejtpërdrejt nga asociacioni, duhet të jenë pjesë e procesit të themelimit të asociacionit. Adresimi i frikës edhe në mesin e serbëve por edhe në mesin e shqiptarëve mund të shndërrohet në pikënisje të re apo kthesë për suksesin e asociacionit.

SHTOJCA I: REZULTATET PËR KOMUNAT VERIORE


PYETJET E ANKETËS








*Të anketuarit kanë pasur mundësi të zgjedhin disa përgjigje nga lista e përgjigjeve të ofruara.





Si i shohin serbët e Kosovës marrëdhëniet e tyre me Kosovën në të ardhmen?









*Të anketuarit kanë pasur mundësi të zgjedhin disa përgjigje nga lista e përgjigjeve të ofruara.




SHTOJCA II: REZULTATET E ANKETËS PËR KOSOVËN QENDRORE²⁰³


PYETJET E ANKETËS




Deri më tani, kush ka ofruar informacione më të sakta për Asociacionin e Komunave Serbe?




A e kuptoni ju se për çfarë janë marrë vesh në Bruksel sa i përket Asociacionit të Komunave Serbe?




A mendoni që institucionet serbe do të mbyllen pas formimit të Asociacionit të Komunave Serbe?




Sipas mendimit tuaj, kur do të formohet Asociacioni i Komunave Serbe?






Beogradi thotë që Asociacioni do të ketë kompetenca ekzekutive. A e besoni ju këtë?







*Të anketuarit kanë pasur mundësi të zgjedhin disa përgjigje nga lista e përgjigjeve të ofruara.



*Të anketuarit kanë pasur mundësi të zgjedhin disa përgjigje nga lista e përgjigjeve të ofruara.







MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK
DANIDA | INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Kosovo

Ky grant është financuar nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) - i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)

Grupi për Ballkan për Hulumtimin e Politikave është organizatë (think tank institute) jo profitabile, e pavarur, rajonale, me seli në Prishtinë, Kosovë. Ne ofrojmë analiza dhe rekomandime mbi një numër çështjesh rreth politikave të shtet-ndërtimit, konsolidimit institucional e demokratik; integritit të minoriteteve, dhe marrëdhënieve ndërshtetërore; si dhe integritit evropian dhe reformave politike. Ekipi i Grupit për Ballkan ka përvojë pesëmbëdhjetëvjeçare në hartimin e raporteve rreth politikave zhvillimore, të menduarit në mënyrë strategjike, dhe avokimit tek qeveritë, shtetet dhe organizatat ndërkombëtare, si dhe ato jo-fitim prurëse.

Thelbi i punës sonë qëndron në raportimet tona rigorozë, të detajuara, të paanshme dhe gjithmonë të bazuara në hulumtimet tona nga terreni e gjeneza e zhvillimeve. Ne shkojmë përtej qëndrimeve të etabluara dhe punojmë që të bëjmë ndryshime përmes rekomandimeve kreative, të realizueshme dhe të matshme, duke kontribuar që shtetet tona të zhvillojnë shoqëri demokratike, të qëndrueshme dhe të suksesshme bazuar në sundimin e ligjit.

Grupi Ballkanik ka dizajnuar edhe instrumente të reja që të arrijë këtë ndryshim, siç janë Dialogu Politik, Forumi Politik (Instrument i avokimit të nivelit të lartë) dhe Forumi Ndër-Kufitar i Bashkëpunimit të Shoqërisë Civile.

Për më shumë, vizitoni web-faqen tonë ose na kontaktoni në office@balkansgroup.org

